



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



KPM-S/2017

STRATEGJIA

PËR KALIM NË TRANSMETIM DIGJITAL

TOKËSOR NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

22 Dhjetor 2017

Përmbajtja

Lista e Përkufizimeve	4
Lista e shkurtesave	6
Përmbledhje Ekzekutive	7
Metodologjia	8
1. HYRJE	11
1.1 Komisioni i Pavarur i Mediave	11
1.2. Korniza Ligjore	11
2. Korniza Teknike për transmetimin tokësor televiziv	13
2.1 Standardet e kompresimit dhe transmetimit	14
2.2. Numërimi Logjik i Kanaleve (Logical Channel Numbering - LCN)	14
2.2. Pajisja Marrëse e Përbashkët (Common Interface)	15
2.3. Udhëzuesi Elektronik i Programit dhe Udhëzuesi Interaktiv i Programit	15
2.4. Plani për radio frekuenca	16
2.5. Zona për transmetim nacional: Allotmenti Kosova	17
2.6. Sub-allotmentet për plotësim të nevojave të popullsisë nëpër regjione	18
2.7. Plotësimi i mbulueshmërisë së Allotmentit Kosova	19
2.8. Modifikimi i pikave ekzistuese transmetuese në Kosovë	20
3. DIVIDENDA DIGJITALE	23
3.1. Çështjet e spektrit në qasjen e përfitimeve nga dividenda digjitale	25
3.2. Shërbimi radio digjital T-DAB	25
4. SEKTORI MEDIAL NË KOSOVË	26
5. PËRFITIMET NGA TRASMETIMI DIGJITAL	28
5.1. Përmirësimi i shfrytëzimit të spektrit frekuencor	28
5.2. Përmirësim i pranimit të sinjalit	29
5.3. Shtimi i kanaleve televizive	29
5.4. Kostoja e transmetimit më e lirë	29
5.5. Formati i ri i fotografisë	29

5.6. Shërbime të reja	29
5.7. Rregullimi i Televizionit Digjital Tokësor (TDT)	29
5.8. Përshkrimi funksional i zinxhirit transmetues DVB-T2	30
5.9. Përmbajtjet programore	31
Parimet themelore të përmbajtjeve programore.....	31
Format e reja teknologjike	32
Programet me interes të përgjithshëm.....	32
Stimulimi i prodhimit të programeve.....	33
Shërbimet mediale audio-vizuale regjionale dhe lokale	33
6. VIZIONI, MISIONI DHE OBJEKTIVAT STRATEGJIKE	33
Misioni	33
6.1. Alternativat e Konsideruara	35
7. PROCESI I IMPLEMENTIMIT TË TELEVISIONIT TOKËSOR DIGJITAL	36
7.1. Faza e parë – periudha tranzitore	37
Implementimi i DTT-së në nivel shtetëror.....	37
7.2 Faza e dytë - çkyçja e transmetimit analog (“switch off”).....	39
8.KORNIZA EKONOMIKO-SHOQËRORE.....	40
Kostoja financiare e kalimit në transmetim digjital	40
Ndikimi financiar për transmetuesit.....	41
Transmetuesi Publik i Kosovës (Radio Televizioni i Kosovës)	41
Stacionet televizive komerciale	41
Ndikimi financiar për shikuesit.....	41
Subvencionimi	42
9. INFORMIMI PUBLIK	43
SHTOJCA 1 - Korniza Ligjore	44
SHTOJCA 2- Të dhënat sipas mbulueshmërisë gjeografike dhe të popullatës	46
SHTOJCA 3 - Lista e operatorëve të shpërndarjes	47
SHTOJCA 4 - Lista e ofruesve të shërbimeve mediale audiovizuale përmes operatorëve të shpërndarjes	48
SHTOJCA 5 - Situata e kanaleve 7, 31, 44, 46, 48, 58 dhe 67 në planin GE-06 për Kosovën	49

Lista e Përkufizimeve

Komisioni i Pavarur i Mediave është organ i pavarur për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit dhe rregullon të drejtat dhe përgjegjësitë e personave juridikë që ofrojnë shërbime mediale, audio dhe audiovizuale, të cilat përkufizohen në Ligjin për Komisionin e Pavarur për Media (në tekstin e mëtejshëm ‘KPM’);

Digjitalizimi – procesi i kalimit nga transmetimet radio difuzive analoge në ato digjitale;

Multipleksi – (në tekstin e mëtejshëm “MUX”) një set i standardizuar i sinjaleve digjitale, i shprehur në Mbit/s (Mega-bit-për-sekondë), që përmban disa programe televizive dhe/ose të radios dhe/ose të dhëna të tjera, të cilat transmetohen dhe emetohen në të njëjtën kohë dhe në mënyrë të thurur;

Ofrues i shërbimit medial - personi fizik apo juridik që ka përgjegjësi redaktuese për përzgjedhjen e përmbajtjes audiovizuale të shërbimit medial dhe që përcakton mënyrën e organizimit të tij;

Operatori i MUX-it-personi juridik që ofron infrastrukturën teknike për shpërndarjen tokësore të programeve digjitale dhe shërbimet suplementare për transmetimin digjital të të dhënave;

Operatori i rrjetit - është çdo person juridik, i cili ofron çfarëdo forme të rrjetit për transmetim të programeve, ose një shërbim transmetimi për publikun dhe posedon licencën korresponduese ose autorizim të lëshuar nga KPM-ja;

Plani Kombëtar i Radio-Frekuencave - nënkupton dokumentin që përcakton brezat frekuencorë për shërbimet e ndryshme dhe kushtet bazike për ndarjen dhe dhënien e frekuencave, me qëllim të sigurimit të shfrytëzimit efektiv të spektrit të radio-frekuencave dhe shmangies së interferencave;

Pranuesi Televiziv Digjital është pajisja për pranimin, dekodimin dhe transformimin e sinjalit televiziv digjital në një formë të përshtatshme për reproduktimin e fotografisë, zërit dhe të dhënave tjera, e cila mund të jetë pajisje e veçantë, e vendosur brenda televizorit, apo në një tjetër pajisje;

Qasja në multipleks - nënkupton shërbimin e ofruar nga operatori i rrjetit përmes rrjetit të komunikimit elektronik, nga pika e qasjes në rrjet;

Transmetim radio-difuziv – shërbimi i emetimit të programeve të radios dhe televizionit nëpërmjet një antene tokësore, rrjetit të komunikimeve elektronike, ose satelitore, në formë të koduar ose jo, për t'u marrë nga publiku;

Transmetimi radio difuziv analog - është transmetimi dhe pranimi i sinjalit analog televiziv dhe/ose të radios përmes transmetuesve tokësorë, në pajtim me standardet relevante ndërkombëtare;

Transmetimi radio difuziv tokësor digjital - është transmetimi dhe pranimi i sinjalit digjital televiziv dhe/ose të radios përmes transmetuesve tokësorë, në pajtim me standardet relevante ndërkombëtare;

Televizioni me kualitet standard (SDTV) - shërbimi i fotografisë dhe zërit të cilësisë standarde, në pajtim me rekomandimet relevante të Unionit Ndërkombëtar për Telekomunikacion (rekomandimet e ITU);

Televizioni me kualitet të lartë (HDTV) - shërbimi që ofron fotografi dhe zë me cilësi më të lartë sesa cilësia standarde, duke i shtuar numrin e linjave analizuese për fotografi, duke ndryshuar metodën e analizës së fotografisë, duke e rritur proporcionin e dimensioneve të fotografisë në 16:9, si dhe duke i ndryshuar karakteristikat kolorometrike të fotografisë, në pajtim me rekomandimet; relevante të Unionit Ndërkombëtar për Telekomunikacion (rekomandimet e ITU).

Transmetim jolinear është ofrimi i shërbimit të programit audio dhe/ose audioviziv për marrje, sipas kërkesës individuale dhe në momentin e zgjedhur nga përdoruesit.

Transmetim linear është ofrimi i shërbimit të programit audio dhe/ose audioviziv për marrje të njëkohshme të tyre nga dëgjuesit dhe/ose shikuesit.

Transmetim pa pagesë është transmetimi, për marrjen e të cilit nuk i paguhet tarifë subjektit që e siguron këtë shërbim.

Kategoria e OSHMA me mbulim shtetëror—Përfshin Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audiovizuale të cilat shpërndahen përmes operatorit të multipleksit shtetëror.

Kategoria e OSHMA me mbulim të zonës regjionale - përfshin Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audiovizuale të cilat shpërndahen përmes operatorit të multipleksit regjional.

Kategoria e OSHMA me mbulim të nën-zonës Prishtina – përfshin Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audiovizuale të cilat shpërndahen përmes operatorit të multipleksit të nën-zonës së kryeqytetit.

Lista e shkurtesave

ASO (Analogue Switch Off) – Ndërprerja e transmetimit analog;

DVB-T (Digital Video Broadcasting Terrestrial)– Video transmetimi tokësor digjital;

DVB-T2 – gjenerata e re e standardit DVB-T;

EPG (Electronic Programing Guide)– Udhëzues Elektronik i programit;

IPG (Interactive Programing Guide)– Udhëzuesi Interaktiv i Programit;

RRC06 – Konferenca Rajonale për Radio-Komunikimin, e mbajtur në Gjenevë në vitin 2006;

GE06 – Plani për transmetim tokësor digjital radiodifuziv që ka rezultuar nga RRC06;

H.264 dhe **H.265/HEVC** – standardet e kompresimit të të dhënave audio- video;

HDTV (High Definition Television) – Televizion me rezolucion të lartë;

ITU (International Telecommunications Union) – Unioni Ndërkombëtar i Telekomunikimit;

MPEG (Moving Picture Experts Group) -Kompresimi i audio dhe video sinjalit për transmetim digjital;

SDTV (Standard Definition Television) – Televizion me rezolucion standard;

SFN (Single Frequency Net[ork]) – Rrjet me frekuencë të njëjtë;

STB (Set-up Box) – resiver/pajisje për pranim të sinjalit digjital;

VHF (Very High Frequency) – frekuenca shumë të larta të spektrit të frekuencave nga 30MHz deri në 300MHz;

UHF (Ultra High Frequency) – frekuenca ultra të larta të spektrit të frekuencave nga 300MHz deri në 3GHz;

Përmbledhje Ekzekutive

Strategjia për digjitalizim definon në mënyrë gjithëpërfshirëse procesin e kalimit të transmetimit televiziv tokësor analog në transmetim tokësor digjital.

Në bazë të Ligjit Nr. 04/L-44, neni 3 pika 1.1, KPM është e ngarkuar me mandatin për të hartuar Strategjinë për kalim në transmetim digjital në Republikën e Kosovës si dhe dokumentet tjera strategjike për shërbimet mediale audiovizual. Strategjia për digjitalizim në mënyrë të qartë përcakton drejtimit strategjike zhvillimore, obligimet dhe afatet kohore të kalimit të transmetimit tokësor analog në atë digjital, në pajtim të plotë me standardet e Unionit Ndërkombëtar të Telekomunikacionit (ITU-së) dhe të Komisionit Evropian.

Transmetimi televiziv digjital do t'iu ofrojë qytetarëve të Republikës së Kosovës shërbime shtesë, cilësi më të mirë të pranimit të sinjalit televiziv, kapacitet më të madh për shumëllojshmëri të ofrimit të përmbajtjeve programore, më shumë programe televizive, shërbime të reja për përdoruesit me nevoja të veçanta dhe për të moshuarit, , pranim portativ dhe mobil (në lëvizje) të programit si dhe konvergjencën e shërbimeve mediale dhe telekomunikuese. Digjitalizimi sjell mundësi të reja për ofruesit e shërbimeve që të ofrojnë përmbajtjen e programit sipas nevojave të grupeve të caktuara të shoqërisë kosovare, ofron inter-aktivitet, ofron mundësi për shërbime sipas kërkesës dhe, mbi të gjitha, përbënë kosto më të ulët të transmetimit në përgjithësi.

Publiku i gjerë do të përfitojë nga përdorimi më efikas i spektrit frekuencor, shfrytëzimi i dividendës digjitale të spektrit për implementimin teknologjik të shërbimeve të reja, promovimi i zhvillimit të teknologjisë dhe mundësive të reja krijuese nga konkurrenca e përmirësuar, mundësi për zgjerim të kreativitetit në kuptimin e ofrimit të shërbimeve si dhe ruajtjen e identitetit kulturor.

Plani frekuencor për transmetim televiziv tokësor digjital është miratuar në Konferencën e Gjenevës, e njohur si RRC-06, në vitin 2006. Rezultat i Konferencës RRC-06 është Akti Final i Konferencës Rajonale të Radio-Komunikimit për Planifikimin e Shërbimit të Transmetimit Tokësor Digjital në pjesët e Rajoneve 1 dhe 3, në brezat e frekuencave 174-230 MHz dhe 470-862 MHz (RRC-06) dhe dy planet e frekuencave GE-06A për analog dhe GE-06D për televizionin digjital tokësor.

Të dyja planet janë në përdorim që nga viti 2006, por për shkak se përfshijnë frekuencat e spektrit të njëjtë, plani analog është i mbrojtur nga plani digjital. Kjo do të thotë se përderisa transmetuesit analogë të regjistruar në regjistrin kryesor janë ende në veprim transmetimi digjital në atë brez frekuencor nuk mund të përdoret. Kjo mbrojtje ka qenë e garantuar nga ITU deri më 17 qershor të vitit 2015, kur periudha kalimtare e procesit të transmetimit digjital ka përfunduar dhe plani GE-06A nuk do të jetë në zbatim. Prandaj, rrjetet analoge tokësore televizive duhet të kalojnë në teknologjinë digjitale, përmes së cilës do të ndryshojë edhe mënyra sipas së cilës shikuesit pranojnë shërbimet mediale audio-vizuele në të ardhmen.

Nga rezultatet e Marrëveshjes RRC-06 territorit të Republikës së Kosovës i janë caktuar vetëm 8 kanale (Multipleks/MUX) dhe 2 pika transmetimi duke e lënë pothuajse gjysmën e territorit të Republikës së Kosovës jashtë mbulimit me sinjal televiziv tokësor digjital.

Plani i vitit 2006 është modifikuar për të siguruar mbulim të plotë për gjithë territorin e Republikës së Kosovës dhe si i tillë prezantohet në këtë Strategji.

Qeveria e Republikës së Kosovës do të ndërmerr të gjitha masat e nevojshme për negociim me Unionin Ndërkombëtar të Telekomunikacionit (ITU) për anëtarësimin e Republikës së Kosovës në këtë organizëm ndërkombëtar. Megjithatë, deri në anëtarësimin e Republikës së Kosovës në ITU, do të përdoret plani aktual i modifikuar për transmetim digjital tokësor televiziv në nivel shtetëror dhe të koordinohet me vendet fqinje për transmetim digjital tokësor televiziv në nivel regional.

Në procesin e kalimit në transmetim digjital duhet të jenë të përfshier shumë palë si: Qeveria me institucionet e saj përbërëse, rregullatori i mediave, ofruesit e shërbimeve audio-vizuele si dhe qytetarët me qëllim të realizimit të suksesshëm të kësaj strategjie kombëtare.

Kjo strategji përcakton veprime adekuate për krijimin e kornizës ligjore, planin hapësinor të frekuencave për transmetim televiziv digjital tokësor, vendosjen e kufijve dhe standardeve të avancuara për përmbajtjet e programeve si dhe propozimin e mbështetjes socio-ekonomike për qytetarët e Republikës së Kosovës, respektivisht propozimin për subvencionim për mundësinë në qasjen e programeve televizive digjitale për shtresat me standard më të ulët ekonomik siç do të përcaktohen nga autoritetet kompetente. Zbatimi i kësaj strategjie ofron kualitet më të mirë dhe transmetim efikas të televizionit dhe përmbajtjeve tjera audio-vizuele që janë me vlerë të lartë për shfrytëzuesit.

Strategjia për ndërprerjen e transmetimit analog dhe kalimin në transmetim digjital në Republikën e Kosovës është përgatitur nga KPM-ja dhe miratohet nga Qeveria, ashtu siç e parasheh Ligji për KPM-në.

Ligji Nr. 05/L-027 për Dixhitalizimin e Transmetimeve Tokësore Radiodifuzive, i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe në fuqi nga muaji shtator 2015, ka përcaktuar metodën dhe kushtet për transmetim digjital tokësor, procedurat për të kaluar nga transmetimi analog në transmetim digjital, planifikimin, zhvillimin dhe përdorimin e rrjeteve, të drejtat për qasje në multipleks për transmetim digjital tokësor dhe çështje të tjera me rëndësi për kalimin në transmetimin digjital. Ligji përmban dispozita për procesin e shkyçjes së transmetimit analog dhe kalimit në transmetimin digjital, si dhe dispozita për të drejtat dhe obligimet gjatë periudhës së shkyçjes së transmetimit analog (ASO). Qëllimi i rregullimit të ri bëhet për të ruajtur përdorimin efikas të spektrit të radio-frekuencave, në përputhje me aktet ligjore ndërkombëtare dhe kombëtare për komunikimet elektronike dhe shërbimet mediale audio-vizuele me mundësitë teknologjike në dispozicion.

Dispozitat ligjore, të cilat rregullojnë fushën e komunikimit elektronik (Ligji për komunikime elektronike) dhe dispozitat ligjore që rregullojnë mediat (Ligji për KPM-në), duhet të zbatohen nga institucionet respektive për çështjet që lidhen me transmetimin digjital.

Metodologjia

Puna në hartimin e Strategjisë për kalim në transmetimin tokësor digjital në Republikën e Kosovës ka filluar në vitin 2010, përmes grupeve punuese të udhëhequra nga Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) si institucion kompetent për rregullimin dhe menaxhimin e spektrit frekuencor dhe licencimin e shërbimeve mediale audio-vizuele në Republikën e Kosovës.

Grupet Punuese janë ndarë në:

- Grupi Punues për Çështje Ligjore,
- Grupi Punues për Çështje të Përmbajtjeve Programore,
- Grupi Punues për Çështje Teknike,
- Grupi Punues për Çështje Shoqërore-Ekonomike dhe
- Grupi Punues për Informim dhe Sensibilizim.

Grupet punuese janë përbërë nga anëtarë që përfaqësojnë institucione të ndryshme si dhe industrinë mediale. Të gjitha grupet punuese janë kryesuar nga anëtarët e KPM-së.

Zhvillimi i strategjisë është bërë në bazë të Udhëzimit Administrativ 02/ 2012 mbi procedurat, kriteret dhe metodologjinë e përgatitjes dhe miratimit të dokumenteve strategjike dhe planeve për zbatimin e tyre, duke marrë për bazë rekomandimet / sugjerimet nga anëtarët e grupit punues.

Në **Grupin e Punës për Çështjet Ligjore**, i cili është udhëhequr nga KPM, pos anëtarëve të KPM-së (Këshillit dhe Zyrës Ekzekutive) ka pasur anëtarë të përfaqësuar edhe nga:

1. Komisioni për Legjislacion i Kuvendit
2. Komisioni për Media i Kuvendit
3. RTK
4. KTV
5. TV 21
6. AMPEK (2 përfaqësues të mediave lokale)
7. Zyra Ligjore e ZKM-së
8. MEF
9. TV Puls
10. Rrokum TV

Në **Grupin e Punës për Çështje të Përmbajtjeve Programore**, i cili është udhëhequr nga KPM, pos anëtarëve të KPM-së (Këshillit dhe Zyrës Ekzekutive) ka pasur anëtarë të përfaqësuar edhe nga:

1. RTK
2. TV 21
3. KTV
4. AMPEK (2 përfaqësues të mediave lokale & Drejtoresha Ekzekutive)
5. Rrjeti i TV stacioneve "TV Mreza" (1 përfaqësues)
6. Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës
7. Universiteti i Prishtinës
8. Asociacioni i Gazetarëve Profesionistë
9. Klan Kosova

Në **Grupin e Punës për Çështjet Teknike**, i cili është udhëhequr nga KPM, pos anëtarëve të KPM-së (Këshillit dhe Zyrës Ekzekutive) ka pasur anëtarë të përfaqësuar edhe nga:

1. UP, Fakulteti Elektroteknik
2. ARKEP

3. MZHE
4. Komisioni për Media, Kuvendi i Kosovës
5. RTK
6. TV 21
7. KTV
8. KTTN
9. AMPEK (2 përfaqësues të mediave lokale)
10. TV Most

Në **Grupin e Punës për Çështjet Ekonomiko-Shoqërore**, i cili është udhëhequr nga KPM, pos anëtarëve të KPM-së (Këshillit dhe Zyrës Ekzekutive) ka pasur anëtarë të përfaqësuar edhe nga:

1. MEF
2. Komisioni për Buxhet dhe Financa i Kuvendit
3. Zyra për Planifikim Strategjik e ZKM
4. Oda Ekonomike
5. Sektori Privat
6. Klubi për Politikë të Jashtme (KPJ)
7. RTK
8. TV 21
9. KTV
10. OK Kujtesa
11. Business Channel

Ndërsa Grupi Punues për Informim Publik është përbërë vetëm nga anëtarë të KPM.

1. HYRJE

1.1 Komisioni i Pavarur i Mediave

Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) është themeluar nga Kuvendi i Kosovës në vitin 2005 me Ligjin Nr. 02/L-15 për Komisionin e Pavarur të Mediave dhe Transmetimin.

KPM është përcaktuar edhe si kategori kushtetuese. Në bazë të nenit 141 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Komisioni i Pavarur i Mediave është organ i pavarur që rregullon spektrin e frekuencave transmetuese në Republikën e Kosovës, licencon transmetuesit publik e privat, përcakton dhe zbaton politikën e transmetimit si dhe ushtron kompetenca të tjera të përcaktuara me ligj.

Ligji Nr. 02/L-15 është ndryshuar dhe Ligji i ri për Komisionin e Pavarur të Mediave Nr. 04/L-44 ka hyrë në fuqi në prill të vitit 2012. Kompetencat dhe autoriteti i KPM-së mbeten të njëjtat. KPM përbëhet nga anëtarët e Komisionit, Zyra Ekzekutive dhe Bordi i Ankesave.

KPM, në bazë të Ligjit Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave, është organ i pavarur për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit. KPM-ja rregullon të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e personave fizikë dhe juridikë që ofrojnë shërbime mediale audio dhe audio-vizuele.

Në bazë të Ligjit Nr. 04/L-44 për KPM-në, KPM-ja përgatit strategjinë për kalimin nga transmetimi tokësor analog në transmetim digjital në Republikën e Kosovës e cila miratohet nga Qeveria. I njëjti ka përcaktuar që do të ketë edhe Ligj të veçantë për kalimin në transmetim digjital. Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar Ligjin Nr. 05/L-027 për Dixhitalizimin e Transmetimeve Radiodifuzive në Kosovë në muajin gusht 2015. Ligji për Digjitalizim ka përcaktuar kushte dhe kriteret, për të siguruar një proces konkurrues dhe të suksesshëm të kalimit nga transmetimi televiziv analog tokësor në atë digjital bazuar në strategjinë për digjitalizim si dhe procedurën e tenderimit publik për lejinin e dy kanaleve, kanalën 46 dhe kanalën 58.

1.2. Korniza Ligjore

Korniza ligjore që ndërlidhet me rregullimin dhe funksionimin e digjitalizimit në Kosovë përfshin Ligjin Nr. 05/L-027 për Dixhitalizimin e Transmetimeve Radiodifuzive në Kosovë dhe aktet nënligjore për procesin e kalimit në transmetim digjital të miratuara nga KPM.

Korniza ligjore që ndërlidhet me krijimin, rregullimin dhe funksionimin e medias së lirë në Kosovë është mjaft e avancuar dhe ka rezultuar me një numër relativisht të lartë të shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale të licencuara në Republikën e Kosovës. Korniza bazë rregullative për shërbimet mediale audio dhe audiovizuale në Republikën e Kosovës, përbëhet nga Ligji i KPM-së Nr. 04/L-44, aktet nënligjore të KPM-së si dhe legjislacioni në fuqi që ndërlidhet me rregullimin e shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale në Republikën e Kosovës. *(Lista e legjislacionit primar dhe sekondar është dhënë në Shtojcën 1)*

Me Ligjin Nr. 05/L-027 për Dixhitalizimin e Transmetimeve Radiodifuzive Tokësore, janë përcaktuar akteret e zinxhirit të transmetimit digjital, procedurat për dhënien në shfrytëzim të frekuencave 46 dhe 58 për transmetim digjital dhe janë përcaktuara të drejtat dhe detyrimet e të

gjithë pjesëmarrësve në prodhimin e përmbajtjeve mediale audiovizuale dhe zinxhirin e transmetimit.

Korniza ligjore ekzistuese në Kosovë që ka të bëjë me rregullimin e autoritetin dhe rolin e KPM-së, në mënyrë të vazhdueshme duhet të plotësohet me qëllim që të rritet efikasiteti i skemës së licencimit, të prezantohen role të reja për subjektet e reja të sektorit të televizionit digjital dhe të hapet rruga për rregullimin e shërbimeve konvergjente.

KPM do të iniciojë reformimin e kornizës ligjore që rregullon radio-difuzionin në Kosovë, duke pasqyruar instrumentet detyruese ligjore të BE-së dhe tranzicionin që pritet nga transmetimi tokësor analog në transmetimin tokësor digjital, do të përcaktojë qartë rolin, të drejtat dhe detyrimet e të gjithë pjesëmarrësve në prodhimin e përmbajtjeve mediale audio-vizuale dhe zinxhirin e shpërndarjes.

Korniza ligjore e reformuar do të mundësojë procedurën publike dhe transparente për dhënien e licencave, duke u bazuar në aspektin neutral të përzgjedhjes në bazë të kërkesës nga ofruesit e përmbajtjes, sipas kushteve paraprakisht të përcaktuara dhe jo-diskriminuese, të përshtatura me llojin e shërbimit, lineare ose jo-lineare, që aplikuesi planifikon të ofrojë.

Pas kalimit në transmetim digjital, në Republikën e Kosovës dhënia e licencave të reja për transmetimin tokësor digjital do të bëhet në pajtim me procedurat e përcaktuara nga korniza ligjore, duke u bazuar në analizat e nevojave të qytetarëve dhe të grupeve shoqërore lidhur me përmbajtjen e medie, në analizën e tregut, por edhe në vlerësimin e ndikimit të ofruesve të rinj në tregun medial. Vendimet për dhënien e licencës duhet të merren për zonat e mbulimit dhe llojin e programeve për të cilat do të jepen licencat e reja.

Me reformimin e kornizës ligjore, KPM garanton fuqishëm të drejtën e qytetarëve për zgjedhje të gjerë të përmbajtjeve mediale, përmes platformave të ndryshme për shpërndarje (satelitore, kabllore, transmetimit tokësor, etj.). Obligimet e operatorëve të platformës, do të caktohen për të transmetuar përmbajtjen e caktuar (must-carry) dhe obligimet e ofruesve të shërbimeve mediale audiovizuale për të ofruar përmbajtjet e tyre pa diskriminim.

Me qëllim të realizimit të interesit publik në fushën e informimit të rëndësishëm për qytetarët në komunitetet lokale dhe regjionale, kuotat proporcionale minimale të programeve lokale dhe regjionale, duhet të përcaktohen me akt nënligjore për të gjithë të licencuarit nga KPM-ja.

KPM-ja do të garantojë konkurrencë të lirë në tregun publik të shërbimeve mediale audiovizuale.

2. Korniza Teknike për transmetimin tokësor televiziv

Në Republikën e Kosovës, për transmetimin tokësor televiziv digjital, duhet të aplikohen këto standarde teknike:

1. MPEG – 4 versioni 10 (H.264/AVC) ose H265 HEVC (High Efficiency Coding) si standard për kompresim të sinjalit digjital;
2. DVB-T2, si standard për emetim radio-difuziv të sinjalit TV digjital;
3. SFN (Single Frequency NetWork), si tip i rrjetit radio-difuziv;

I. Format i kompresimit të sinjalit MPEG-4 v.10 ose AVC (Advanced Video Coding), është i standardizuar sipas ISO/IEC 14496-10. Rekomandohet përdorimi i standardit të ri H265, që mundëson shtim prej 39% deri 44% të kapacitetit transportues në krahasim me H264 dhe siguron më shumë TV programe brenda kanalit të njëjtë.

II. Standardi DVB-T2, ka shumë parametra të cilët përcaktohen sipas tipit të rrjetit, konfiguracionit, sasisë së përmbajtjes, kualitetit të kërkuar, etj.

III. IP Rrjeti Kontributiv, që shërben për bartjen e sinjalit të përmbajtjeve programore nga Ofruesit e përmbajtjes TV, të cilët multipleksit ia përcjellin sinjalin e koduar në TS (Transport Stream). Rekomandohet që transporti i sinjalit nga ofruesi i përmbajtjes deri tek MUX të bëhet duke shfrytëzuar fibrin optik për mundësitë më të mira që i ofron në lidhje me kualitetin, koston dhe sigurinë. Kjo nuk e ndalon përdorimin e broadcast linqeve, që nënkupton teknologjinë ASI të bartjes së sinjaleve, dërgimin (kontribuimin) RF dhe satelitor për nevoja të transmetimit tokësor digjital.

IV. Head-End (Multipleksi qendror), është pjesë e sistemit të telekomunikacionit digjital radiodifuziv, i cili bën grumbullimin e TV programeve (ofruesit e përmbajtjes) dhe të bashkuara i përcjell deri te transmetuesi.

V. IP Rrjeti Distributiv, për shpërndarje të sinjaleve nga Multipleksi qendror nëpër pika transmetuese, duke shfrytëzuar protokolet RTP (Real-time Transmission Protocol) nëpërmjet UDP-së (User Datagram Protocol) gjatë bartjes së sinjaleve përmes fijeve optike si dhe përdorimi i RF Broadcast linqeve, që nënkupton mënyren ASI të bartjes së sinjaleve. Rrjeti distributiv duhet të garantojë 100% disponueshmëri të sinjalit deri tek pikat transmetuese duke përdorur teknikë unazore dhe mbrojtje 1+1 në të gjitha nivelet. Rekomandohen të gjitha format e mundshme që ofron teknologjia për bartjen e sinjalit nga MUX-i deri te pika e transmetimit.

VI. Rrjeti Radio-difuziv, bën emetimin e sinjaleve digjitale TV deri te shfrytëzuesit e fundit nëpërmjet sistemeve emituese të vendosur nëpër pika të larta.

VII. SFN - mundëson që brenda një zone mbulueshmërie (allotment) të gjithë transmetuesit të punojnë të sinkronizuar dhe në frekuencë të njëjtë, në atë mënyrë që sinjali TV të mbërrij në kohë dhe me përmbajtje të njëjtë tek shfrytëzuesi i fundit.

Bazuar në përvojat më të mira në implementimin e DVB-T2 në Evropë, propozohet që distribucioni primar i sinjaleve (në kuadër të Rrjetit Kontributiv dhe Distributiv), të bëhet duke

shfrytëzuar IP teknologjinë, konkretisht RTP nëpërmjet UDP-së në mënyrë që përveç mundësive të procesimit dhe shkëmbimit më efikas, edhe në këtë nivel të jetë kompatible me teknologjitë tjera siç është IPTV etj.

Përshkrimi i mëposhtëm i zinxhirit të transmetimit digjital tokësor është paraqitur grafikisht dhe i detajuar në vijim:



Korniza teknike Fig. 1 –Zinxhiri i aktiviteteve dhe lidhjeve në transmetimin digjital

2.1 Standardet e kompresimit dhe transmetimit

Në Kosovë do të zbatohet formati MPEG-4 si teknikë e kompresimit si dhe standardi DVB-T2.

Kompresimi	Kanalet SD	Kanalet HD
MPEG-2/DVB-T	4/8	1
MPEG-4/DVB-T	8/12	2/3
MPEG-4/DVB-T2	14/18	4/6

Korniza teknike Tabela 1 – Kompresimi dhe kapaciteti i kanaleve SD dhe HD

Dizajni i formatit MPEG-4, bazuar në gjendjen e tanishme të teknologjisë dhe projektimin për prodhimin e komponentëve të integruara elektronike VLSI (CPUs, SPS, Asic s, FPGAs, etj) siguron ekuilibrin aktual ndërmjet efikasitetit të kodimit, zbatimit e kompleksitetit dhe koston.

Ky standard është rekomanduar edhe nga ITU-ja (Rekomandimi ITU-R BT.1737), dhe shumë vende të cilat kanë filluar me MPEG-2, tani janë duke kaluar nëpër një tranzicion në MPEG-4 për shkak të përparësisë së saj teknike dhe të një cilësie më të mirë.

Nisur nga nevoja e atyre vendeve me treg më të zhvilluar të transmetimit të cilët kanë përjetuar një mungesë të kapacitetit të rrjeteve/spektrit të frekuencave DTT, konsorciumi DVB ka nxjerr specifikacionet (2009) për teknologjinë DVB-T2 si një pasardhës i standardit DVB-T. Standardi i ri DVB-T2 ofron një efikasitet 30-50% më të mirë në krahasim me DVB-T. Për shkak të papajtueshmërisë me standardin e përdorur gjerësisht të DVB-T, standardi i ri DVB-T2 nuk është projektuar për të zëvendësuar DVB-T në afat të shkurtër dhe të mesëm. Problemi është shumë i ngjashëm me situatën e papajtueshmërisë në mes të MPEG-2/MPEG-4 që rezultoi në një periudhë të re të tranzicionit dhe përfshinte pasigurinë e tregut dhe koston shtesë si për shikuesit ashtu edhe për transmetuesit. Për këtë arsye, standardi DVB-T2 pritet të bashkëjetoj me DVB-T për disa vite. Gjithashtu, vlen të përmendet se vendet me tregje të zhvilluara të transmetimit do të prezantojnë të dyja sistemet njëkohësisht MPEG-4 edhe DVB-T2 lidhur me formatin e ri të përmbajtjes (HDTV).

2.2. Numërimi Logjik i Kanaleve (Logical Channel Numbering - LCN)

Një nga tiparet e standardit DVB-T është mundësia për të paraqitur klasifikim automatik të kanaleve televizive, që ruhen në çdo televizor individual. Në një mjedis ku ka shumë kanale, siç është platforma digjitale televizive tokësore, pozita e një kanali televiziv të veçantë në

telekomandën e përdoruesit është e rëndësishme. KPM do të përcaktojë kriteret për renditjen logjike të kanaleve me akt të veçantë nënligjor.

2.2. Pajisja Marrëse e Përbashkët (Common Interface)

Zhvillimi i televizionit digjital (në frekuencat satelitore, frekuencat tokësore dhe kablllore) dhe, mbi të gjitha, futja e televizionit me pagesë (Pay-TV) dhe platforma e qasjes së kushtëzuar, ka gjeneruar një numër të gjerë të pajisjeve për dekodim, e cila synon që vetëm shikuesit e identifikuar me një kod specifik të shikojnë programin e dëshiruar.

Problemi me dekodim është se çdo ofrues i shërbimit që ofron përmbajtje të veçanta (Premium), nëpërmjet kanaleve televizive me pagesë, mund të përdor një kod për dekodim që ndryshon nga të tjerët. Si pasojë, konsumatori i cili dëshiron për të parë kanalet në dispozicion në më shumë se në një platformë, e koduar ndryshe, duhet të sigurojë një dekoder për çdo sistem të sinkronizuar. Statistikat e sjelljes së konsumatorit tregojnë se, kur ka më shumë se një dekoder në dispozicion në treg, konsumatori ka më shumë probleme në zgjedhjen e ofruesit të shërbimit.

Në rast të zbatimit të shërbimeve të televizionit me pagesë, resiverët duhet të jenë të pajisur me "Pajisjen Marrëse të Përbashkët" (Common Interface), një standard i përcaktuar që mundëson shtimin e një moduli të kushtëzuar për qasje (Conditional Access Module - CAM) në pranues DTV për ta përshtatur me lloje të ndryshme të kriptografisë. Poashtu, pranuesi i fundit duhet të jetë i përcaktuar me standardin kodues të ITU-T H.265/HEVC që e përkrah edhe standardin H.264.

Pajisjet marrëse të përbashkëta duhet të jenë në përputhje me standardin EN 50221, respektivisht me standardet bashkëkohore. Ky është një standard i përcaktuar që mundëson shtimin e një moduli, për qasje të kushtëzuar (CAM), në një resiver DTV për ta përshtatur atë me lloje të ndryshme të kriptografisë. Në të vërtetë, një nga pikat e forta kryesore të transmetimit digjital të videos është opsioni i zbatimit të aftësive të kërkuara për qasje të kushtëzuar në hapësirën e përbashkët.

2.3. Udhëzuesi Elektronik i Programit dhe Udhëzuesi Interaktiv i Programit

Udhëzuesi elektronik i programit (Electronic Programme Guide- EPG) është një meny e përditësuar e cila vazhdimisht i ofron përdoruesve të televizionit, radios dhe mediave tjera, aplikacione për të hulumtuar, zgjedhur dhe shikuar (ose dëgjuar) përmbajtjen duke përdorur një telekomandë, maus (kompjuteri), tastierë apo pajisje tjera. Informatat rreth transmetimit të programit apo skemës programore përditësohen vazhdimisht.

Udhëzuesi Interaktiv i Programit (Interactive Program Guide – IPG) është një aplikacion që u mundëson shikuesve dhe dëgjuesve të navigojnë në mënyrë interaktive menunë e programit, të për zgjedhin dhe shfletojnë sipas kohës, titullit, stacionit apo zhanrit duke përdorur pajisje hyrëse të tilla si tastatura, tastatura kompjuterësh ose teledirigjues televiziv. Standardet për ofrimin e orarit të informatave në televizion – të bazuara në udhëzuesin interaktiv të programit, ndryshojnë nga aplikacioni në aplikacion dhe varësisht nga shteti. Në Evropë, Instituti Evropian për Standarde të Telekomunikacionit (ETSI), ka publikuar standardin ETS 300 707, për të standardizuar ofrimin e të dhënave IPG përmes sinjaleve digjitale televizive të transmetuara. Listimet e të dhënave për IPG të integruara në pranuesit e sotëm të televizioneve tokësore

digjitale dhe radiove, kryesisht, dërgohen brenda rrjedhjes transportuese të MPEG të çdo stacioni, ose së bashku me të në një rrjedhje të veçantë të të dhënave.

KPM-ja do të përcaktojë kriteret dhe specifikat që të gjithë operatorët e rrjetit dhe ofruesit e shërbimeve të përputhen me to, me qëllim të krijimit të një EPG dhe IPG kompatible me udhëzuesit e ofruar nga operatorët/ofruesit e tjerë.

2.4. Plani për radio frekuenca

Sipas Marrëveshjes GE-06, një zonë për transmetim (allotmenti “Kosova”) është planifikuar për të mbuluar 52% të territorit të Republikës së Kosovës, por pikat testuese të zonës përkatëse për transmetim nuk korrespondojnë me kufijtë aktual të vendit.

Rezultatet e konferencës rajonale RRC – 06 - për Republikën e Kosovës një zonë për transmetim (allotment) dhe dy pika transmetimi (assignments) janë planifikuar për të akomoduar tetë (8) SFN rrjete digjitale tokësore. Një (1) kanal i frekuencave është i caktuar në brezin frekuencor III dhe, shtatë (7) kanale frekuencore janë në brezin frekuencor IV/V.

Të gjitha kanalet janë caktuar dhe regjistruar në planin e të dyja pikave transmetuese, Golesh dhe Cvilën. Zonat për mbulim janë planifikuar në bazë të llojit të planifikimit referues të konfigurimit 2 (RPC-2).

Ky konfigurim referencë, do të përdoret kur pranuesi i jashtëm portativ ose cilësia më e ulët e mbulimit të pranuesit të brendshëm, ose pranuesi lëvizës është planifikuar. Rrjeti është i bazuar në rrjetin e referimit 1 (RN1).

Emri i zonës për transmetim (allotment)	Kanalet
Kosova	7, 21, 31, 44, 46, 48, 58, 67


Korniza teknike / Tabela 2 - Frekuencat e planifikuara sipas RRC-06 për zonën për transmetim “Kosova”

Problemi i parë i planit GE-06 është se fuqia efektive rrezatuese (ERP) e të dy pikave transmetuese të planifikuara, është 40 dBW në vend të 49,7 dBW , që korrespondon me fuqinë tipike sipas Rrjetit të Referencës 1 (RN1) dhe i cili, është përdorur për të planifikuar mbulimin e një fushe të gjerë të shërbimit SFN.

Sipas këtij rrjeti të planifikuar, shtatë transmetues janë vendosur në qendër dhe në vertikale të një rrjeti gjashtëkëndorë (shih tabelën 3).

Reference planning configuration and reception type		RPC 1 Fixed antenna	RPC 2 Potable outdoor and mobile	RPC 3 Portable indoor
Type of network		Open	Open	open
Geometry of service area		Hexagon	Hexagon	Hexagon
Number of transmitters		7	7	7
geometry of transmitter lattice		Hexagon	Hexagon	Hexagon
Inter-transmitter distance d/km		70	50	40
Service area diameter D/km		161	115	92
Tx antenna height/m		150	150	150
Tx antenna pattern		non-directional	non-directional	non-directional
ERP / dBW	Band III	31.1 + Δ	33.2 + Δ	37.0 + Δ
	Band IV/V	39.8 + Δ	46.7 + Δ	49.4 + Δ

The power margin Δ is 3 dB



Reference planning Configuration	RPC1	RPC2	RPC3
Location probability	95%	95%	95%
Reference C/N (dB)	21	19	17
(Emed)ref (dB μ V/m) at 200 MHz	50	67	76
(Emed)ref (dB μ V/m) at 650 MHz	56	78	88

Korniza teknike / Tabela 3 - Parametrat e rrjetit të referencës 1 (RN1 – një hapësirë më e gjerë e shërbimit)

Sistemet transmetuese me fuqi rrezatuese prej 49,7 dBW , kanë sisteme të antenave me diagram rrethor të rrezatimit dhe zona e shërbimit është supozuar të jetë 115 km në diametër. Dy pikat e transmetimit janë aktualisht nën mbikëqyrjen e KFOR-it, që e bën situatën edhe më komplekse.

Rrjetet ekzistuese televizive analoge, të vendosura në 20 pika transmetimi (6 kombëtare dhe 14 lokale/rajonale), me infrastrukturë të përshtatshme që mund të përdoren për transmetimin digjital, nuk janë marrë parasysh .

Problemi i dytë është fakti se, sipas planit të GE06, rreth 48% e territorit të Kosovës nuk është i mbuluar me zonën e propozuar për transmetim " allotmenti Kosova". Dy pikat transmetuese të përfshira në Plan, sigurojnë mbulimin e 28% të zonës aktuale për transmetim, por nëse marrim në konsideratë se kufijtë e zonës për transmetim nuk përputhen me kufijtë e vendit d.m.th. vetëm 16,1% e territorit të Kosovës mund të mbulohet me sinjal digjital televiziv tokësor (DTT).

2.5. Zona për transmetim nacional: Allotmenti Kosova

Kanalet 7, 21, 31, 44, 46, 48, 58, 67 mundësojnë shtrirje të sinjaleve TV digjitale në tërë territorin e Kosovës, dhe të ofruesve të shërbimeve (Shërbimet e multipleksëve) të përzgjedhura për këtë shtrirje.

Kanali 67 është i caktuar për dividendën digjitale dhe që nga data 17 qershor 2015 nuk është i mbrojtur për transmetim televiziv tokësor sipas standardeve të ITU-së.

Me Planin Gjeneva 2006 lloji i rrjetit për mbulim nacional është SFN.

Me qëllim të ekonomizimit, redukimit të radiacionit, mbulueshmërisë më efektive, rekomandohet shfrytëzimi i pikave emetuese kryesore (assignment) ekzistuese:


Goleshi – me diagram rrezatimi rrethor, polarizim horizontal dhe me fuqi rrezatuese deri në 100Kë (UHF) dhe deri në 25 KW (VHF).

Vneshta – me diagram rrezatimi në tri drejtime kryesore dhe një ndihmës, polarizim horizontal dhe fuqi rrezatuese deri në 5 KW (UHF) dhe deri në 1.5 KW (VHF).

Zatriqi – me diagram rrezatimi në tri drejtime kryesore dhe një ndihmës, polarizim horizontal dhe fuqi rrezatuese deri në 20 KW (UHF) dhe deri në 5 KW (VHF).

Cërnusha – me diagram rrezatimi në tri drejtime kryesore dhe një ndihmës, polarizim horizontal dhe fuqi rrezatuese deri në 5 KW (UHF) dhe deri në 1.5 KW (VHF).

Maja e Gjelbër – me diagram rrezatimi në tri drejtime kryesore dhe një ndihmës, polarizim horizontal dhe fuqi rrezatuese deri në 5 KW (UHF) dhe deri në 1.5 KW (VHF).



Korniza teknike Fig.2 – Rrjeti i transmetimit

Korniza teknike Fig.3 – Ndarjet regjionale

Pikat emetuese të paraqitura në figurën 1, paraqesin rrjetin primar të emetuesve, që janë pjesë e fazës së parë të planifikimit; faza e dytë e planifikimit, duhet të përfshijë ato pjesë të Kosovës që do të mbulohen vetëm pjesërisht në fazën e parë. Në fund duhet të planifikohet dhe realizohet faza e tretë, e mbulimit me sinjale DVB-T2, me përsëritës apo të ashtuquajturit “gap fillers”.

2.6. Sub-allotmentet për plotësim të nevojave të popullsisë nëpër regjione

Bazuar në Kapitullin 4 të Marrëveshjes Finale Gjeneva 2006, KPM do të bëjë koordinim me vendet fqinjë për të siguruar kanale të painterferuara për suballotmentet. Koordinimi do të bëhet për sub-allotmentet që përfshijnë zonat regjionale ndarja e të cilave bazohet në këto kriteret:

- Gjeografik;
- Demografik;
- Ekonomik; dhe
- Reduktimi maksimal i mundshëm i radiacionit jonizues duke u koncentruar në pikat e transmetimit.

KPM do të përcaktojë frekuencat e nevojshme për ndarjet e sub-allotmenteve:

- Suballotmenti i Rrafshit të Kosovës;
- Suballotmenti i Rrafshit të Dukagjinit;
- Suballotmenti i Mitrovicës;
- Suballotmenti i Anamoravës; dhe
- Suballotmenti i Prishtinës.

Për çdo regjion do të caktohen edhe pikat e transmetimit:

- për rrafshin e Kosovës, Maja e Goleshit;
- për regjionin e Dukagjinit, Maja e Zatriqit;
- për regjionin e Mitrovicës, Maja e Cërnushës; dhe
- për regjionin e Anamoravës, Maja e Gjellbërt.

Një suballotment i veçantë ndahet për kryeqytetin e Republikës së Kosovës, për të plotësuar nevojat e shtuara si rezultat i koncentrimit të madh të popullsisë, institucioneve qendrore shtetërore, institucioneve të shumta edukativo-arsimore, kulturore, sportive, bizneseve dhe potencialit të lartë financiar. Praktikë të këtillë kanë ndjekur të gjitha vendet anëtare të ITU-së, të cilat kanë nga një suballotment për kryeqytetin.

2.7. Plotësimi i mbulueshmërisë së Allotmentit Kosova

Në këtë strategji, Plani RRC-06 është modifikuar për të plotësuar nevojat për transmetim digjital tokësor televiziv në tërë territorin e Kosovës. Plani i modifikuar duhet të implementohet për shkak të përparësisë që ofron në mënyrë që të fillohet me procesin e digjitalizimit të rrjeteve transmetuese tokësore. Kjo strategji e transmetimit digjital siguron katër zona regjionale për transmetim, një nën-zonë për transmetim për kryeqytetin dhe zonën kryesore për transmetim digjital në tërë territorin e Republikës së Kosovës (fig.2), krahasuar me vetëm një zonë për transmetim, siç ishte planifikuar në Konferencën e Gjenevës, në vitin 2006. Arsyeja pse është propozuar ky modifikim, përveç mbulimit më kuantitativ dhe kualitativ me sinjale TV digjitale, është që edhe të bëhemi të barabartë me vendet fqinje¹.

Ndarja në zona për transmetim është bërë në aspektin gjeografik, duke vlerësuar se nga kjo mund të krijohen mundësi për rrjetet rajonale të transmetimit. Kanalet e reja që do të propozohen pas aprovimit të kësaj strategjie, (përveç atyre të aprovuara nga ITU-ja), nuk janë rezultat i RRC-06, dhe si të tilla ato duhet të koordinohen me vendet fqinje (Shqipërinë, Maqedoninë, Serbinë dhe Malin e Zi) pasi që të njëjtat ekzistojnë në planin e Gjenevës si frekuenca të lira, duke lënë mundësinë që secili prej fqinjëve, mund t'i përdorë ato për rrjetet regjionale.

Në tabelën 4 janë paraqitur kanalet e parapara për mbulim nacional, sipas frekuencave të aprovuara nga ITU-ja dhe suballotmentet sipas planit të modifikuar (për të cilat do të bëhet koordinimi me shtetet fqinjë për caktim të frekuencave të reja regjionale).

¹ Kosova është i vetmi vend që ka përfunduar vetëm me një zonë për transmetim, përderisa nëse krahasohet me Republikën e Maqedonisë, që ka një mbulim të ngjashëm por me 8 zona për transmetim, së bashku me një të veçantë për kryeqytetin. Shqipëria ka 11 zona për transmetim dhe një për kryeqytetin, Serbia ka 20 zona për transmetim dhe një shtesë për kryeqytetin, Mali i Zi ka 3 zona për transmetim dhe një për kryeqytetin.

Emri i zonës së paraparë për mbulim sipas RRC-06	Kanalet emetuese
Allotmenti Kosova	7, 21, 31, 44, 46, 48, 58 dhe 67
Emri i zonës së paraparë për mbulim sipas planit të modifikuar	Kanalet emetuese
Sub allotmenti i Rrafshit të Kosovës	Do të koordinohen
Sub allotmenti i Rrafshit të Dukagjinit	Do të koordinohen
Sub allotmenti i Mitrovicës	Do të koordinohen
Sub allotmenti i Anamoravës dhe	Do të koordinohen
Sub allotmenti i Prishtinës	Do të koordinohen

Korniza teknike Tabela 4 – Kanalet e parapara për transmetim digjital për territorin e Kosovës sipas ITU-së dhe planit të modifikuar

Kriteret që do të përdoren për koordinim duhet të jenë në përputhje me parimet bazë të ITU-së duke u kujdesur që të mos shkaktojnë interferenca të dëmshme në vendet fqinje. Do të përdoren frekuenca që nuk do të interferojnë.

2.8. Modifikimi i pikave ekzistuese transmetuese në Kosovë

Në planin GE-06 dy pika transmetuese janë planifikuar për t'u përdorur në Kosovë. Pika transmetuese e Goleshit është e vendosur në afërsi të Prishtinës dhe Cvileni është një kodër mbi Prizren. Të dyja këto pika kanë fuqinë maksimale efektive të përhapjes prej 40 dBë. Pikat e transmetimit nuk janë duke u përdorur për rrjetin televiziv analog tokësor por janë duke u përdorur nga KFOR-i.



Një vend alternativ për Golesh do të jetë shumë i vështirë për t'u gjetur, por pika transmetuese e Cvilen-it mund të ndryshohet me një pikë tjetër transmetuese ekzistuese analoge në Zatriq. Vendndodhja në Zatriq është e pozicionuar 32 km në veri të Cvilen-it dhe është më afër pjesës qendrore të Kosovës. Pika e re transmetuese ka një lartësi të ulët por siguron mbulim më të mirë të territorit të Kosovës. Modifikimi i pikës transmetuese të Cvilen-it me Zatriq nuk rrit ndërhyrjet në kanalet e njëjta me vendet fqinje.

Lidhur me Fuqinë e Përhapjes Efektive të dyja pikat transmetuese mund të përdorin 49,7 dBë pasi kjo fuqi korrespondon me modelin e planifikuar të rrjetit referencë RN1. Fuqia prej 49,7 dBë është dhjetë herë më e lartë se sa fuqia e 40 dBë. Në vat kjo do të thotë që në vend të 10.000ë fuqia efektive e përhapjes të ndryshimit të propozuar do të jetë 93.325ë.

Emri i pikës transmetuese	Koordinatat gjeografike			E regjistruar
	Gjatësia	Gjerësia	Lartësia mbidetare	
Golesh	20.5859	42.3407	1018 m	GE-06
Cvilen	20.4454	42.1020	1380m	GE-06
Zatriq	20.37315	42.26793	1036m	Modifikim i Cvilen

Korniza teknike Tabela 5 - Modifikimi i propozuar për pikën transmetuese Cvilen

Simulimi i përhapjes së pikës transmetuese të modifikuar tregon se ndikimi në vendet fqinje nuk ka ndryshuar (shih figurën 4.)



Korniza teknike / Figura 4 - Llogaritja e mbulimit të modifikuar (Cvilen -majtas, Zatriq-të djathtas). Cvilen : 49,7 dB μ V (56 dB μ V / m për pritjen fikse), Zatriq: 40 dB μ V (56 dB μ V / m për pranim fikse, 78 dB μ V / m për pranim portativ, pranim mobil)

Ndryshimi i pikës transmetuese Cvileni, propozohet të zhvendoset në Zatriq në mënyrë që të arrihet mbulim më i mirë. Ndërhyrjet, nivelet e pengesave (interferencave) në shtetet fqinje do të jenë më të pakta, për shkak të pozitës gjeografike të Zatriqit dhe lartësisë mbidetare më të ulët në krahasim me Cvilenin. Duhet theksuar se zhvendosja është në kuadër të diametrit të lejuar nga kriteret e ITU-së, brenda 30 km në vijë ajrore.

Zona ekzistuese për transmetim mund të shtrihet në veri, për të mbuluar pjesën tjetër të vendit. Mbulimi tipik i rrjetit RPC2/RN1 ka një diametër prej 115 km dhe territori i Kosovës është pak më i madh sesa kjo zonë e planifikuar e mbulimit, që nënkupton se distanca nga kufiri perëndimor në atë lindor të Kosovës është rreth 135 km dhe largësia në mes të veriut dhe jugut është 154 km. Sinjali pranues digjital tokësor portativ i jashtëm, apo në modelin lëvizës, nuk është i mundur jashtë perimetrit të zonës së shërbimit prej 135 km, ku fuqia mesatare e fushës është 78 dB μ V/m. Termi i modelit portativ të jashtëm përdoret kur sinjali është marrë nga pajisja portative me pranim të ulët të antenës. Pranimi lëvizës (mobil), do të thotë, pranimi i sinjalit në automjete lëvizëse.

Megjithatë, jashtë kësaj zone, forca mesatare e fushës do të jetë mjaft e lartë, për të ofruar sinjal pranimi me anë të antenave të vendosura në çati (56 dB μ V / m). Duke pasur parasysh se antenat e vendosura lartë në çati, janë duke u përdorur gjerësisht për të marrë sinjale analoge televizive, pjesa tjetër e vendit gjithashtu, do të mbulohet mjaftueshëm me sinjale televizive digjitale. Me përdorimin e DVB-T2, mundësohet diagrami konstativ i rotulluar, që siguron sinjal të mjaftueshëm, deri në 5dB përfitim (gain), që do të thotë se, edhe kur forca mesatare e fushës është 51 dB μ V / m, pranimi i sinjalit në antenën e vendosur lartë në çati është i mundur.

Vlen të theksohet se madhësia e sipërfaqes së zonës së re të propozuar për transmetim është e krahasueshme, e ngjashme, me zonat e vendeve fqinje. Kjo është e rëndësishme për fushën e qasjes së barabartë të spektrit të frekuencave. Ndryshimi i madhësisë së zonës për transmetim, mund të ketë efekt mbi ndarjet e kanaleve të njëjta (zonë për transmetim të vendeve fqinje që përdorin frekuencë të njëjta), ndërsa distanca mes tyre duhet të jetë e mjaftueshme për të mos shkaktuar ndërhyrje të dëmshme të ndërsjella. Në Figurën 3, zona ekzistuese për transmetim është zgjeruar në drejtim të veriut (zona me shirita).

Madhësia është e ngjashme me zonat e tjera për transmetim në vendet fqinje dhe, distanca në mes të zonës për transmetim të kanaleve të njëjta në Republikën e Serbisë, nuk duhet të jetë një problem, ndërsa distanca në drejtim të Maqedonisë është shumë e shkurtër dhe është akorduar gjithashtu në RRC-06, në mes të Serbisë dhe Maqedonisë. Fotografia tregon situatën në kanal 21, ndërsa situata e kanaleve të tjera (7, 31, 44, 46, 48, 58, 67) në planin GE-06 për Kosovën, është paraqitur në Shtojcën 5.




Korniza teknike / Figura 5 - Zgjerimi i allotmentit Kosova

Modifikimi i zonës për transmetim "Allotmenti Kosova" është propozuar me pikat e reja testuese të paraqitura në tabelën 4. Këto pika do të përdoren kur bëhet ndryshimi i formës së zonës për transmetim, në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes GE-06.

Modifikimet e propozuara të zonës për transmetim "Allotmenti Kosova"			Zonat ekzistuese për transmetim sipas planit RRC-06 "Allotmenti Kosova"		
Pt	Gjatësia	Gjerësia	Pt	Gjatësia	Gjerësia
1	21°E37'30''	42°N15'20''	1	21°E9'46''	42°N49'58''
2	21°E27'16''	42°N17'30''	2	21°E37'30''	42°N15'20''
3	21°E21'4''	42°N14'0''	3	21°E27'16''	42°N17'30''
4	21°E17'39''	42°N9'22''	4	21°E21'4''	42°N14'0''
5	21°E17'34''	42°N6'37''	5	21°E17'39''	42°N9'22''
6	21°E13'47''	42°N6'47''	6	21°E17'34''	42°N6'37''
7	21°E10'43''	42°N12'43''	7	21°E13'47''	42°N6'47''
8	21°E5'15''	42°N13'2''	8	21°E10'43''	42°N12'43''
9	20°E46'14''	42°N5'16''	9	21°E5'15''	42°N13'2''
10	20°E43'36''	41°N59'12''	10	20°E46'14''	42°N5'16''
11	20°E45'4''	41°N55'29''	11	20°E43'36''	41°N59'12''
12	20°E37'8''	41°N52'19''	12	20°E45'4''	41°N55'29''
13	20°E38'27''	41°N57'55''	13	20°E37'8''	41°N52'19''
14	20°E32'15''	42°N13'16''	14	20°E38'27''	41°N57'55''
15	20°E20'57''	42°N20'28''	15	20°E32'15''	42°N13'16''
16	20°E16'0''	42°N20'19''	16	20°E20'57''	42°N20'28''
17	20°E12'30''	42°N29'12''	17	20°E16'0''	42°N20'19''
18	20°E4'16''	42°N34'11''	18	20°E12'30''	42°N29'12''
19	20°E08'30''	42°N40'04''	19	20°E4'16''	42°N34'11''
20	20°E03'52''	42°N45'46''	20	20°E22'9''	42°N33'54''
21	20°E13'07''	42°N45'43''			
22	20°E30'48''	42°N52'57''			

23	20°E42'30''	43°N06'56''
24	20°E37'44''	43°N12'26''
25	20°E48'13''	43°N15'55''
26	20°E50'18''	43°N10'18''
27	21°E09'37''	43°N00'21''
28	21°E24'25''	42°N50'16''
29	21°E23'04''	42°N44'59''
30	21°E38'43''	42°N40'29''
31	21°E45'36''	42°N41'05''
32	21°E37'59''	42°N27'24''
33	21°E30'56''	42°N20'31''

Korniza teknike/ Tabela 6 - Modifikimi i propozuar për zonën për transmetim "Allotmenti Kosova"



Korniza teknike/ Figura 6 dhe 7 - Forma e zonave të reja për transmetim dhe zonave të reja dhe të vjetra për transmetim – krahasimi (kufijtë e vendit me të zeza, kufijtë e zonës për transmetim me të bardha)

3. DIVIDENDA DIGJITALE

Kalimi nga transmetimi analog në atë digjital i programeve televizive, do të ofrojë për transmetim një numër të konsiderueshëm të programeve televizive brenda një kanali ekzistues televiziv, në rezolucion standard (SD) si dhe në atë me rezolucion të lartë (HD), duke mundësuar që të lirohet një numër i madh i kanaleve frekuencore.

Strategjia për kalim nga transmetimi televiziv analog në digjital, parasheh për transmetim të programeve televizive përdorimin e standardit më efikas aktual (DVB-T2), dhe në këtë mënyrë, ofron një numër të madh të programeve brenda një kanali të vetëm frekuencor. Në anën tjetër, standardi i kompresuar për sinjal video dhe audio, brenda një programi të vetëm televiziv (MPEG-4 v.10), do të zvogëlojë në mënyrë efikase hapësirën që kërkohet për të transmetuar një program të vetëm televiziv.

Zgjedhja për përdorimin e teknologjisë më të fundit, si dhe të arkitekturës së rrjetit për shpërndarje të programeve televizive në Republikën e Kosovës, në mënyrë efikase ofron shfrytëzimin e spektrit të frekuencave të radios, dhe në këtë mënyrë maksimalizon dividendën digjitale.

Duke u mbështetur në rezultatet e studimit të vendeve të Bashkimit Evropian, si dhe rezultatet e Konferencës Botërore të Radiove (WRC-07), në Strategji është definuar dividendë digjitale. Strategjia parasheh që për hapësirën e frekuencave të radios, që korrespondojnë me kanalet televizive brenda brezit/rangut 61-69 UHF (790-862 MHz), të mos përdoren për transmetime televizive, por për shërbime brezgjëra pa tela (wireless broadband services).

Gjithashtu, BE-ja ka miratuar Rekomandimin EU C(2009)8287 më 20 tetor 2009 (duke lehtësuar lirin e dividendës digjitale në Bashkimin Evropian), duke rregulluar përdorimin e këtij brezi, më shumë i njohur si 800 MHz, kjo është “Dividendë 1”.

Parlamenti Evropian, përveç brezit 800 MHz, gjithashtu propozon, përcaktimin e kanaleve prej brezit 700 MHz të vendoset veçmas si “Dividendë Digjitale 2”, gjithashtu, edhe për zhvillim të shërbimeve të brezit të gjerë (broadband services).

Dividendë digjitale duhet të merret parasysh pas vitit 2015, kështu që frekuencat më lartë se 790 MHz nuk duhet të përdoren për transmetim digjital tokësor televiziv.

Unioni Ndërkombëtar i Telekomunikacionit (ITU) dhe Bashkimi Evropian, kanë shtruar detyrën për zhvillimin e sistemeve, rrjeteve dhe shërbimeve të brezit të gjerë deri në vitin 2020. Bashkimi Evropian ka miratuar Agjendën Digjitale 2020. Këto detyra tregojnë se është e nevojshme për të lënë mënjane segmentin më të madh të mundshëm të spektrit të radio frekuencave, si dividendë digjitale, dhe për t'i caktuar ato për sisteme mobile të brezit të gjerë. Kapaciteti total i vlerësuar i dividendës digjitale në Republikën e Kosovës duhet të ketë parasysh numrin e kanaleve televizive të kërkuara në rezolucion standard dhe atë me rezolucion të lartë gjatë periudhës pas kalimit në transmetim digjital. Palët përgjegjëse për menaxhimin e spektrit do të përcaktojnë madhësinë e dividendës digjitale.

Strategjia inkorporon çështjen e dividendës digjitale dhe merr parasysh aktet ligjore ekzistuese të BE-së (*EU acquis*)². Në mënyrë të veçantë, kapitulli 4 i Akteve Finale GE06, lë jashtë rëndësinë strategjike të përdorimit të efektshëm të dividendës digjitale, që është ngushtë i lidhur me menaxhimin efikas të spektrit – çelës për në Europë 2020 dhe objektiv i Agjendës Digjitale për Evropë (Digital Agenda for Europe - DAE), për rritje të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse. Kjo veçanërisht është e rëndësishme, për të rritur zgjerimin dhe qasjen në brezin e gjerë (broadband)/internet i shpejtë.

Komunikata për transmetim të Brezit të Gjerë (Broadband Communication), e shtatorit të vitit 2010 (COM 2010 472), thekson: “Politika Programore e Spektrit të Radio frekuencave, e propozuar nga Komisioni, do të sigurojë atë pjesë të dividendës digjitale – frekuencat e radios të liruara nga largimi nga transmetimi analog në digjital – të rezervuara për përdorim nga teknologjia e brezit të gjerë pa tela (Wireless broadband technologies).

Kjo është veçanërisht e rëndësishme për shkak se brezi i gjerë pa tela mund të sjellë lidhje të shpejtësisë së lartë për njerëzit në zonat e largëta, apo për të tjerët ku nuk është e mundur

² Legjislacioni relevant i BE-së në lidhje me këtë:

Direktiva e Kornizës (Direktiva 2002/21/EC e Parlamentit dhe Këshillit Evropian, i datës 7 mars 2002, për një kornizë të përbashkët rregullative për rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike);

Komunikimet prej Komisionit të Këshillit, Parlamenti Evropian, Komisioni Evropian për Ekonomi dhe Social dhe Komisioni i Regjioneve në shqyrtim të ndërveprimit të shërbimeve digjitale televizive interaktive sipas Komunikimit COM(2004) 541;

Komunikimet prej Komisionit të Këshillit, Parlamenti Evropian, Komisioni Evropian për Ekonomi dhe Social dhe Komisioni i Regjioneve për shpejtimin e kalimit prej transmetimit analog në digjital COM(2005)204 final.

ekonomikisht të zbatohet instalimi i linjës fikse. Komisioni Evropian është duke kërkuar nga shtetet anëtare të rrisin mekanizmat duke lëshuar shpejt licenca për operatorët, për të përdorur brezat e spektrit që janë harmonizuar teknikisht në nivel të BE-së, për përdorim të brezit pa tel dhe për të hapur brezin 800 MHz, për brezin e gjerë pa tel deri në vitin 2013”.

3.1. Çështjet e spektrit në qasjen e përfitimeve nga dividenda digjitale

Pasi që dividenda digjitale duhet të shfrytëzohet nga shërbimet “pa tel brezgjërë-Wireless broadband”, në mbarë botën (ose të paktën në mbarë rajonin), harmonizimi i frekuencave është një kusht i domosdoshëm. Harmonizimi i tillë do të krijojë përfitime të mëdha, në aspektin e ndikimit social dhe rritjen e produktivitetit. Në veçanti, operatorët mobil dhe prodhuesit e pajisjeve do të jenë në gjendje për të trajtuar një treg të madh, duke rritur ekonominë e tyre dhe reduktuar koston e lartë për teknologjitë telekomunikuese.

Para se të aktivizohen transmetuesit digjital në këto kanale, duhet të bëhen analiza të interferencave të dëmshme, që janë të mundshme gjatë operimit të kanaleve analoge në vendet fqinje. Deri në vitin 2015, kanë qenë të mbrojtur plani analog GE-06A dhe ai digjital GE-06D. Përdorimi i një kanali digjital, i cili është ende në përdorim për televizionin analog, duhet të koordinohet me vendet fqinje.

Analizat e interferencave potenciale të dëmshme, duhet të hulumtohen për çdo kanal potencial, bazuar në të dhënat e planit të GE-06A dhe GE-06D.

3.2. Shërbimi radio digjital T-DAB

Sipas GE-06, shërbimi i radios digjitale T-DAB, i gjithë territori i Kosovës është caktuar në një zonë për transmetim (allotment), dhe pikat testuese kanë përcaktuar kufijtë e kësaj zone, ashtu që dimensionet e allotmentit janë të njëjta me dimensionet e allotmenteve për shërbimet televizive digjitale DVB-T në brezat frekuencor VHF dhe UHF. Për shërbimin radio T-DAB janë rezervuar 2 blloqe (11B dhe 12D) në brezin VHF.

Karakteristikat teknike të zonës për transmetim (allotment) dhe pikës për transmetim (assignment) sipas GE-06 janë:

Emri i allotmentit:	Cvileni
Referenca e rrjetit:	RN5
Tipi i marrjes:	RPC4
Kanalet e rezervuara:	11B dhe 12D
Brezi frekuencor:	216- 230 MHz
Gjerësia e kanalit:	1.75 MHz

Për T-DAB, janë përcaktuar dy konfigurime të planifikimit referencë (RPC), RPC 4 për rastet e marrjes së lëvizshme dhe, RPC 5 për marrjet portative të brendshme, si në tabelën me poshtë.

Konfigurimi i planifikimit referencë	RPC 4	RPC 5
Probabiliteti i vendosjes	99%	95%
Referenca C/N (dB)	15	15
Referenca $(E_{med})_{ref}$ (dB(μ V/m)) at $f_r = 200$ MHz	60	66
$(E_{med})_{ref}$: Vlera referencë për minimumin mesatar të intensitetit të fushës RPC 4: RPC për marrje të lëvizshme		

Implementimi i shërbimit T-DAB kryesisht varet nga dinamika e procesit të tranzicionit, sidomos kur bëhet fjalë për fikjen e transmetuesve analog, të cilët transmetojnë programe televizive në brezin VHF. Në Kosovë, brezi frekuencor TV/VHF shfrytëzohet për transmetim të programit televiziv të RTK 1.

Duke pas parasysh këtë, fillimi i implementimit të T-DAB, do të ndodhë në fazat e mëvonshme të procesit të tranzicionit, kur të krijohen kushtet për fikjen e transmetuesve analog, që transmetojnë sinjal televiziv në brezin TV/VHF (ASO).

Pas periudhës së shkyçjes të transmetuesve televiziv analog (ASO), planifikohet të hartohet strategji e re, për shërbimet transmetuese tokësore audio-digjitale.

Në vendet evropiane, implementimi i shërbimit T-DAB, deri më tani ka qenë i kufizuar. Arsyeja kryesore e ngecjes së implementimit të shërbimit T-DAB, i referohet kostos relativisht të lartë të pranuesve (resiverëve), madje edhe në shtetet që kanë realizuar gati në tërësi kalimin nga transmetimi analog në atë digjital, me ç'rast janë krijuar kushtet për lirim të një pjese të brezit frekuencor në VHF, nga transmetuesit TV analog.

Sipas përvojave të vendeve evropiane, kalimi në transmetimin digjital të audio sinjalit në standardin T-DAB, është paraparë për vitin vitin 2017.

4. SEKTORI MEDIAL NË KOSOVË

Kanalet televizive me transmetim tokësor – Në Kosovë janë 3 kanale televizive me transmetim tokësor me mbulim nacional dhe 17 kanale televizive me transmetim tokësor me mbulim lokal dhe rajonal. Kanalet me mbulim tokësor nacional janë *Radio Televizioni i Kosovës*, kanal televiziv i transmetuesit publik (*RTK1*), si dhe *TV 21* dhe *Koha Vizion (KTV)* të licencuara si kanale televizive private komerciale.

Për qytetarët e Kosovës, televizioni mbetet burimi më i rëndësishëm i informatave. Si një trashëgimi nga e kaluara, Kosova është e ndarë në 5 regjione të transmetimit: Prishtinë, Pejë, Prizren, Mitrovicë dhe Gjilan. Por, tregu i mediave mbetet i dominuar nga stacionet televizive të vendosura në Prishtinë, të cilat transmetojnë në mbarë vendin. Nga 20 ofruesit e shërbimit medial audiovizual, 13 transmetojnë në gjuhën shqipe: Televizioni i Kosovës (*RTK1*) transmeton rreth 15% të programit në gjuhët e pakicave; 5 televizione të tjera transmetojnë program në gjuhën serbe dhe 1 në gjuhën turke.

Transmetuesi publik - *Radio Televizioni i Kosovës*, programi i parë (*RTK1*), transmeton program 24 orë në ditë, duke mbuluar nëpërmjet transmetimit tokësor rreth 62.7% të territorit të Kosovës dhe 80% të popullatës. Ndërsa, programi i dytë i transmetuesit publik (*RTK 2*), i themeluar sipas Ligjit nr. 04/L-046 për Radio Televizionin e Kosovës, është licencuar nga KPM si Ofrues i Shërbimit Medial Audiovizual për transmetim të programit në gjuhën serbe dhe operon që nga qershori 2013 me program 24 orë në ditë. Sinjali i RTK 2 bartet vetëm në rrjetet kablllore.

Transmetuesit privat me mbulim tokësor nacional: Televizioni 21 (TV 21) dhe Koha Vizion (KTV) kanë arritur mbulueshmëri pothuajse të njëjtë sikurse të transmetuesit publik RTK1.

Të tre televizionet me mbulim nacional, transmetojnë program edhe nëpërmjet operatorëve të shpërndarjes (kabllo dhe IPTV) dhe satelitor. Kompania e quajtur Rrjeti Tokësor i Transmetimit të Kosovës (RTTK) kryen shërbime transmetimi për nevojat e 3 televizioneve nacionale (RTK1, TV21 dhe KTV) dhe 3 radio stacioneve nacionale (radiot publike Radio Kosova 1 dhe Radio Kosova 2 dhe radio private Radio 21).

Transmetuesit privat komercial me mbulim tokësor regjional dhe lokal: TV Besa, TV Ballkan, TV Dukagjini, TV Festina, TV Herc, TV Iliria, TV Liria, TV Mir, TV Mitrovica, TV Most, TV Opinion, TV Prizreni, TV Puls, TV Syri Vision, TV Tema, TV Vali dhe TV Zoom operojnë duke përdorur pika transmetimi / rrjete transmetuese private. Të gjitha televizionet regjionale dhe lokale së bashku mbulojnë rreth 68.14% të territorit të Republikës. Përkundër faktit se një numër i konsiderueshëm i kanaleve televizive operojnë në rrjetin tokësor analog, ende ka rajone të Kosovës që nuk kanë qasje në sinjalet televizive.

Problemi më i madh mbetet mos-shfrytëzimi i domosdoshëm për transmetim televiziv i Majës së Goleshit, një prej pikave kryesore për transmetim në Republikën e Kosovës. Pjesa e sipërme e kësaj pike transmetuese, që është 1019 m lartësi mbidetare, përdoret vetëm për qëllime ushtarake nga forcat e KFOR-it, kurse pjesa e poshtme, e cila është 969 m lartësi mbidetare, është lejuar që të përdoret vetëm për transmetim në brezin FM për katër transmetuesit me mbulim nacional: dy kanale të RTK-së: Radio Kosova 1 dhe Radio Kosova 2, si dhe dy kanale private: Radio 21 dhe Radio Dukagjini.

Nëse televizionet do të mund të transmetonin nga pjesa e sipërme e Majës së Goleshit, mbulimi do të rritej deri në 90% të territorit të Kosovës. Me riaktivizimin e kësaj pike transmetuese, duke përdorur edhe repetitorët, mund të mbulohet edhe rajoni i Dragashit i cili nuk ka qasje në sinjalet tokësore analoge të televizioneve kosovare.

Edhe pse KPM-ja ka licencuar një numër të subjekteve transmetuese lokale në Prizren dhe Dragash, nuk ka mbulim me sinjal cilësor për shumicën e qytetarëve të kësaj pjese të Kosovës. Forma e vetme e qasjes në shërbimet mediale audio-vizuele të popullatës së Dragashit, sigurohet nëpërmjet platformës satelitore dhe operatorëve të shpërndarjes. Përveç Dragashit edhe disa pjesë të rajonit të Mitrovicës (Skënderaj, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok), në rajonin e Podujevës (Orllan), Kaçanik, Han të Elezit si dhe në rajonin e Anamoravës (Pogragjë) nuk kanë pranim cilësor të sinjalit televiziv të transmetuesit publik (RTK1).

Është obligim ligjor i RTK 1 që të përmbush përgjegjësinë publike për të mbuluar tërë territorin e Republikës së Kosovës dhe për të siguruar qasjen në programin e vet për të gjithë qytetarët e Kosovës. Nga 20 shërbimet mediale televizive me transmetim tokësor të licencuara nga KPM-ja, tre (3) i përkasin kategorisë me mbulim nacional, dhjetë (10) me mbulim regjional dhe shtatë (7) me mbulim lokal. Kategorizimi i tanishëm është i bazuar në mbulueshmëri dhe parametrat teknik. (Shtojca 2)

Radio kanalet me transmetim tokësor -Në Republikën e Kosovës operojnë katër radio stacione me mbulim nacional tokësor, prej të cilave dy janë radio të transmetuesit publik (Radio Kosova 1 dhe Radio Kosova 2), dhe dy janë radio private (Radio 21 dhe Radio Dukagjini).

Janë edhe 83 radio stacione tjera të nivelit lokal dhe regional dhe transmetimi i tyre bëhet nga rrjetet vetanake të tyre. Nga 83 shërbimet audio mediale (radio), 50 radiostacione transmetojnë program në gjuhën shqipe, 23 radiostacione në gjuhën serbe, 3 radiostacione në gjuhën boshnjake, 3 në gjuhën turke, 2 në gjuhën gorane, 1 në gjuhën rome dhe 2 radio stacione janë radio multi-etnike ndërsa 2 radiot e transmetuesit publik (*Radio Kosova 1* dhe *Radio Kosova 2*) transmetojnë rreth 15% të programit në gjuhët e pakicave.

Ofruesit e shërbimeve mediale audiovizuale përmes operatorëve të shpërndarjes (kabllo, IPTV dhe OTT) – Ofrimi i shërbimeve mediale audiovizuale përmes operatorëve të shpërndarjes në vitet e fundit është përhapur shpejtë dhe ka rritur diversitetin e programeve dhe kanaleve në Kosovë.

Operatorët kabllorë janë licencuar fillimisht në bazë të rregullores së miratuar nga KPM në vitin 2007, e cila është zëvendësuar më pas me Rregulloren për Shpërndarjen e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale (Rregullorja KPM – 2016/01). Operatorët e Shpërndarjes duhet të paraqesin një aplikacion për licencë për ofrimin e shërbimeve mediale audiovizuale në nivel nacional janë të obliguar që të transmetojnë RTK 1, RTK 2, TV21, KTV, Klan Kosova, Tribuna Channel; Rrokum TV; TV Kim; Firts Channel; TV Kiss; pa pagesë në rrjetet e tyre; ndërsa, shërbimet në nivel regional dhe lokal janë: TV Mitrovica; TV Balkan; TV Besa; TV Opinion; TV Prizreni; TV Dukagjini; TV Herc; TV Iliria; TV Liria; TV Tema; TV Mir; TV Most; TV Syri Vision; TV Puls; TV Vali dhe TV Zoom. Operatorët e shpërndarjes duhet të aplikojnë rregullën “bartje e detyrueshme” (must-carry) edhe për të gjitha stacionet lokale/regjionale televizive, në bazë të zonës së tyre të mbulimit. RTK 1 është e detyruar t’i ofrojë operatorit të shpërndarjes programin e njëjtë që transmeton në rrjetin tokësor. (*Shtojca 3*).

Në mungesë të frekuencave për licencë televizive, KPM-ja në vitin 2007, përmes Rregullores CIMC 2007/04 për Distribucionin Kabllor të Programeve Radio-Televizive në Kosovë, e më pas në vitin 2017, përmes Rregullores për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale (KPM – 2017/02) krijoi bazën ligjore për licencimin e ofruesve të shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale të cilët janë licencuar në mënyrë individuale. (*Shtojca 4*)

5. PËRFITIMET NGA TRASMETIMI DIGJITAL

5.1. Përmirësimi i shfrytëzimit të spektrit frekuencor

Strategjia e përcakton kornizën për kalimin nga transmetimi analog në transmetim digjital të programeve radio - televizive në bazë të të arriturave bashkëkohore në transmetimin digjital, në mënyrë që të sigurojë cilësi më të mirë dhe më efikase të transmetimit të televizionit, radios, multimedias dhe përmbajtjeve të tjera me vlerë të madhe për përdoruesit.

Sistemi i transmetimit digjital tokësor është i bazuar në Ndarjen Ortogonale të Multipleksit të Frekuencave (OFDM), duke përdorur një numër të madh të bartësve në kanalën e njëjtë të frekuencës. Prandaj, kanali përdoret me më shumë efikasitet për të arritur kapacitetin në maksimum prej 31.67 Mbit/s, i cili mund të akomodojë deri në 10 kanale standarde televizive, të kompresuara në formatin MPEG-4. Në rast të përdorimit të DVB-T2/MPEG-4, kapaciteti është rritur në 50,59 Mbit/s, e cila korrespondon me 14-18 kanale standarde televizive. Në rrjetin digjital kanalet televizive ndajnë të njëjtën frekuencë, përderisa, në sistemin analog secili kanal televiziv ka kanalën e vet të frekuencës. Me aplikimin e Rrjetit me frekuencë të njëjtë (Single Frequency Netëork - SFN), të gjithë transmetuesit në rrjet ndajnë të njëjtën frekuencë, përderisa në analog, çdo transmetues televiziv në rrjet përdor frekuencë të ndryshme. Duke përdorur

sistemin digjital tokësor DVB-T2, bëhet përmirësim substancial i shfrytëzimit të spektrit frekuencor.

5.2.Përmirësim i pranimi të sinjalit

Përhapja e sinjalit OFDM është shumë më e efektshme në krahasim me atë analog. Sinjali digjital, për nga natyra e përhapjes, dallon nga ai analog dhe si rezultat ka zvogëlimin e dukshëm të ndërhyrjeve (interferencave). Përveç kësaj, sinjalet nga më shumë transmetues që përdorin frekuencën e njëjtë në rrjetin SFN do të rrisin efikasitetin e shfrytëzimit të frekuencës. Në transmetimin digjital, fotografia televizive do të jetë pa të ashtuquajturat efektet e "hijeve" dhe "puplave" që janë tipike në transmetimin analog.

5.3 Shtimi i kanaleve televizive

Në transmetimin analog tokësor në Evropë, spektri i transmetimit mund të ofrojë 3-4 rrjete kombëtare, ndërsa në planin frekuencor digjital secili vend ka mundësi të krijojë numër shumë më të madh të rrjeteve kombëtare. Çdo rrjet digjital mund të japë 10 kanale televizive, respektivisht, 80 programe televizive në DVB-T ose 16 kanale televizive që mundësojnë 128 programe televizive në DVB-T2, që është 10 deri në 16 herë më shumë se kanale televizive analoge. Megjithatë, spektri radiodifuziv i transmetimit ende konsiderohet si një burim i kufizuar. Kapaciteti i rrjeteve digjitale ofron mundësinë e prodhimit të më shumë kanaleve televizive, kryesisht tematike, brenda një kanali frekuencor. Për më tepër, kalimi në TV digjital është një politikë e iniciuar nga ana e qeverisë, e cila ka për synim shfrytëzimin racional të spektrit të frekuencave dhe e cila do të sjellë përfitime për konsumatorë duke ofruar më shumë zgjedhje të kanaleve televizive dhe shërbimeve si dhe të nxisë përfitimet në industri përmes të hyrave të reja dhe modeleve të biznesit.

5.4. Kostoja e transmetimit më e lirë

Rrjetet digjitale janë 30-40% më të shtrenjta në krahasim me ato analoge, por për shkak të faktit se i njëjti rrjet digjital përdoret nga më shumë se një kanal televiziv, çmimi për kanal është më i ultë sesa në analog, që do të thotë se, kostoja e transmetimit është më e lirë.

Digjitalizimi siguron mundësitë për ofruesit e përmbajtjes që të rregullojnë përmbajtjen e programit për nevojat e grupeve të ndryshme të caktuara. Poashtu siguron interaktivitetin, potencialin për të ofruar shërbimet 'services on demand' dhe kosto më të ulët të transmetimit dhe konvergjimit të shërbimeve.

5.5 Formati i ri i fotografisë

Përderisa në sistemin televiziv analog fotografia ka format standard, me kornizë përpjesëtimi 4:3, televizioni digjital ofron mundësinë për të transmetuar përmbajtje në format përpjesëtimi 16:9 dhe në formatin me definicion të lartë (HDTV).

5.6. Shërbime të reja

Përveç kanaleve televizive, televizioni digjital mund ofrojë edhe shërbime të tjera, shërbime shtesë, siç janë udhëzuesit elektronik të programit dhe shërbime multimediale. DVB-T digjitale mund të ofrojë çdo përmbajtje digjitale, siç është "ndarja e të dhënave".

5.7. Rregullimi i Televizionit Digjital Tokësor (TDT)

Institucionet dhe organizatat kompetente në Republikën e Kosovës janë të angazhuara në mënyrë aktive në kompletimin e procesit të kalimit nga transmetimi analog në atë digjital të sinjaleve televizive tokësore, duke zbatuar të gjitha aktivitetet që lidhen me këtë proces, duke respektuar të

drejta e shërbyesve medial audiovizuel të siguruara nga licencat e tyre për transmetim televiziv, në përputhje me detyrimet ndërkombëtare dhe kornizën rregullative ekzistuese.

Televizioni digjital sjell ndryshime të mëdha në krahasim me atë analog. Shërbimet mediale audiovizuale të tanishme bëhen ofrues të shërbimeve mediale audio-vizuele, ndërsa shërbimet e emetimit dhe transmetimit të programeve televizive ofrohen nga shërbimi i multipleksit. Kështu, spektri i frekuencave për transmetim do të shfrytëzohet në mënyrë më efikase përderisa konkurrenca në treg do të rritet së bashku me rritjen e kapaciteteve për përmirësimin e punës krijuese dhe për ruajtjen e identitetit kulturor.

Procesi i kalimit nga transmetimi analog në atë digjital, gjithashtu, kërkon një kosto shtesë për qytetarët, për t'u pajisur me një pranues (resiver) për sinjal digjital tokësor televiziv. Republika e Kosovës, në këtë drejtim, do t'i kushtojë vëmendje të veçantë shtresave me standard më të ulët ekonomik dhe personave me nevoja të veçanta. Nëpërmjet stimulimeve të ndryshme dhe subvencioneve, atyre do të duhej t'iu sigurohet një status i veçantë në procesin e digjitalizimit.

Në mënyrë që të mundësohet funksionalizimi i televizionit digjital tokësor në Republikën e Kosovës duhet të plotësohen kërkesat minimale duke përcaktuar dispozitat për rregullimin e subjekteve/pjesëmarrësve të rinj në zinxhirin e transmetimit digjital, ofruesit e përmbajtjes dhe shërbimin e multipleksit si dhe duke përcaktuar, nën kushte të caktuara, rregullën "bartje e obligueshme (must-carry)" në sektorin audio-vizuel.

5.8. Përshkrimi funksional i zinxhirit transmetues DVB-T2

Ofrues i Shërbimit Medial Audiovizual (OSHMA) – personi fizik ose juridik i cili ka përgjegjësi redaktuese për përzgjedhjen e përmbajtjes audiovizuale të ofruesit të shërbimit media dhe përcaktimin e mënyrës së organizimit të tij;

Licenca për të prodhuar dhe shpërndarë një program televiziv nuk mbulon të drejtën për të hyrë në multipleks, pavarësisht digjital izimit, pasi që platforma tokësore ende konsiderohet si një burim i rrallë.

Prandaj, një licencë e përgjithshme përcakton çështjet e ndërlidhura me përmbajtjen, ndërsa një licencë shtesë është e nevojshme për të shpërndarë një kanal televiziv nëpërmjet platformës digjitale tokësore.

Operatori i multipleksit - është personi juridik që ofron infrastrukturën teknike për shpërndarjen tokësore të programeve digjitale dhe shërbimet suplementare për transmetimin digjital të të dhënave;

Sinjali i prodhuar nga ofruesi i përmbajtjes paraqet një burim sinjali digjital në hyrje të multipleksit.

Multipleksi pranon përmbajtjet programore audiovizuale në formë digjitale dhe e shumëfishon (mikson në multipleks) me burimet tjera të sinjaleve, në mënyrë që të krijohet sinjali digjitali shumëfishuar (i multipleksuar).

Operatori i rrjetit - është çdo person juridik, i cili ofron çfarëdo forme të rrjetit për transmetim të programeve, ose një shërbim transmetimi për publikun dhe posedon licencën korresponduese, ose autorizim të lëshuar nga KPM-ja;

Mënyra e funksionimit dhe rregullimit të zingjirit transmetues të ofruesit të përmbajtjes, shërbimit të multipleksit dhe operatorit të rrjetit janë të përcaktuara me Ligjin për Digjitalizim Nr. 05/L-027.

5.9. Përmbajtjet programore

Parimet themelore të përmbajtjeve programore

Komisioni i Pavarur i Mediave, gjatë procesit të kalimit të transmetimit nga ai analog në atë digjital, do të përcaktojë kriteret kryesore të përmbajtjeve programore të shërbimeve mediale audio-vizuale që veprojnë në Republikën së Kosovës duke pasur parasysh:

- objektivin e shoqërisë kosovare për të ndërtuar një shoqëri të lirë dhe demokratike me barazi ndërmjet të gjithë qytetarëve;
- për të inkurajuar krijimin e një klime të favorshme të tolerancës në mes të grupeve të ndryshme etnike, fetare, gjinore, kulturore dhe politike;
- për të avancuar më tej integrimin e vendit në strukturat euro-atlantike;
- për të inkurajuar përmirësimin e vazhdueshëm të jetës kulturore dhe arsimore, kushtet e përgjithshme të jetesës së qytetarëve të Kosovës, si dhe
- për të siguruar ruajtjen e paqes dhe sigurisë;
- nevojën për të lehtësuar ndërmarrjen dhe zhvillimin e aktiviteteve për individët dhe industrinë e prodhimit të programeve që përmbajnë informacione, program edukativ dhe kulturor;
- nevojën që transmetuesit e Kosovës të sigurojnë që shërbimet mediale audio-vizuale, nën juridiksionin e tyre t'i japin prioritet promovimit të prodhimit dhe qasjes së përmbajtjes për shoqërinë kosovare dhe atë evropiane;
- diversitetin kulturor dhe mundësitë e zhvillimit të cilësisë profesionale të përmbajtjes së programit në përgjithësi;
- realitetin dhe diversitetin e shërbimeve mediale audio-vizuale si dhe interesat e tyre në Republikën e Kosovës;

Programet audio-vizuale duhet të respektojnë dhe promovojnë vlerat themelore të shoqërisë dhe liritë e individit të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me Konventën Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut. Para se gjithash, programet audio-vizuale duhet të respektojnë dhe afirmojnë dinjitetin, lirinë, barazinë, solidaritetin dhe të drejtat qytetare, duke informuar qytetarët në mënyrë të gjithanshme dhe objektive rreth ngjarjeve të ndryshme me interes të përgjithshëm publik.

Përmbajtjet programore audio dhe audio-vizuale, duhet të dëshmojnë korrektësi, besueshmëri dhe profesionalizëm. Ato duhet të bazohen në fakte, të jenë të paanshme, duke respektuar dallimet e mendimit në lidhje me fenomenet apo problemet e ndryshme, duke mos lejuar ndikimin e palëve të përfshira ose grupeve të interesit.

Prodhuesit dhe transmetuesit e programeve audio-vizuale janë të detyruar që në përputhje me Ligjin për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta dhe të rregulloreve adekuata të KPM-së,

të respektojnë në mënyrë të prerë të drejtat e autorit, gjatë procesit të prodhimit të programeve të tyre, si dhe gjatë procesit të transmetimit të programeve të huaja.

KPM do të përcaktojë standarde dhe kritere për përmbajtjet programore për të krijuar kushte të drejta dhe të barabarta për të gjitha palët me interes, me qëllim të mbrojtjes së lirisë së shprehjes si dhe pluralizmit medial, si për transmetuesin publik, po ashtu edhe për transmetuesit privat në nivel nacional, regjional dhe lokal. Kjo do të bëhet me qëllim të ofrimit të kushteve të drejta për ofruesit e shërbimeve programore për qasje në rrjetin e transmetimit digjital tokësor dhe zhvillimit të pluralizmit përmbajtësor medial.

Bazuar në Ligjin për KPM-në, Konventën Evropiane për Televizionin Ndërkufitar, dhe në Direktivën për Shërbime Mediale Audio-Vizuele të BE-së (AVMS), KPM-ja krijon kornizën themelore të përmbajtjes programore, në varësi të llojit të shërbimit medial audio-vizuel, që vepron në Republikën e Kosovës.

Format e reja teknologjike

Format e reja teknologjike për ofrimin e shërbimeve të avancuara të përmbajtjeve audio-vizuale dhe multimediale, mund të ndahen në kategoritë e mëposhtme:

- TV Mobile;
- Televizion i rezolucionit të lartë (HDTV);
- Televizioni Interaktiv dhe
- Video me kërkesë (VoD).

Konvergenca e rrjeteve dhe shërbimeve ofron mundësinë e ndarjes së prodhimit të përmbajtjeve programore nga transmetimi dhe shpërndarja e tyre, gjë që ju mundëson prodhuesve të përmbajtjeve programore të koncentrohen vetëm në prodhimin e përmbajtjeve programore që është veprimtari kryesore e tyre.

KPM përmes akteve nënligjore do të përcaktojë rregullat dhe kategoritë e veçanta të subjekteve të licencuara, përkatësisht, ndarjen e qartë të veprimtarisë që ka të bëjë me prodhim të programeve nga ajo e transmetimit dhe shpërndarjes së tyre.

Programet me interes të përgjithshëm

Përmbajtjet audio-vizuale me interes të përgjithshëm për publikun e gjerë në Republikën e Kosovës, konsistojnë në:

- Programe informative përmes së cilave qytetari i Republikës së Kosovës, pa dallim etnie, gjinie, besimi fetar apo bindjeje politike realizon të drejtën për informim të drejtë dhe të pavarur;
- Programe të cilat promovojnë të drejtat njerëzore, me qëllim të zhvillimit të një shoqërie të lirë e demokratike;
- Programe edukative, arsimore, kulturore dhe zbavitëse, të dedikuara për fëmijë dhe të rritur;
- Programe për personat me aftësi të kufizuara dhe me nevoja të veçanta;
- Programe që promovojnë identitetin kulturor dhe trashëgiminë kulturore të Kosovës;

- Programe që afirmojnë dhe mbështesin zhvillimet kulturore dhe krijimtarinë artistike në Republikën e Kosovës;
- Programe që promovojnë kulturën e dialogut publik;
- Programe të dedikuara për mbrojtjen e ambientit dhe të shëndetit;
- Programe që promovojnë edukimin akademik, promovimin akademik të fjalës së shkruar, kulturës gjuhësore si dhe ligjërimin e rrjedhshëm;
- Programe që promovojnë vlerat evropiane.

Obligimet për përpjesëtueshmërinë e emetimit të programeve me origjinë Evropiane caktohen me akt të veçantë. KPM-ja, si rregullator i shërbimeve mediale audio-vizuale në Republikën e Kosovës, obligohet që raportet për përpjesëtueshmërinë e skemave programore, në veçanti për televizionet me mbulueshmëri nacionale të transmetimit, t'ia paraqes Kuvendit të Republikës së Kosovës në raportet e rregullta vjetore.

Në praktikat më të mira të Bashkimit Evropian, shtetet anëtare sigurojnë që shërbimet mediale audio-vizuale, në bazë të kërkesës së ofruar nga ofruesit e shërbimeve mediale, të promovojnë prodhimin dhe qasjen në produksionet evropiane.

Stimulimi i prodhimit të programeve

KPM-ja do të iniciojë themelimin e një fondi për stimulim të prodhimit të një spektri të gjerë programesh të llojeve të ndryshme. Ky fond do të jetë i hapur për të gjithë ofruesit e përmbajtjeve programore dhe për prodhuesit e pavarur. Subvencionimi do të realizohet përmes një konkursi publik.

Mekanizmat ligjorë për realizimin e stimulimit të prodhimit të programeve, përmes këtij fondi, do të caktohen nga KPM përmes një akti të veçantë.

Shërbimet mediale audio-vizuale regjionale dhe lokale

Gjatë kalimit në transmetim digjital, KPM-ja do të inkurajojë shërbimet mediale audio-vizuale regjionale dhe ato lokale, që të krijojnë identitetin e tyre duke kultivuar përmbajtjet programore të cilat trajtojnë problemet e rajoneve të caktuara apo bashkësive lokale në të cilat ato veprojnë.

6. VIZIONI, MISIONI DHE OBJEKTIVAT STRATEGJIKE

Vizioni

Zhvillimi i një shoqërie të lirë, të informuar dhe demokratike dhe avansimi i jetës kulturore dhe arsimore të qytetarëve të Kosovës përmes digjitalizimit i cili ofron shtim të kanaleve televizive, ulje të kostos së transmetimit, shërbime të reja, rregullim të televizionit digjital tokësor dhe vendosje të standardeve për përmbajtjen programore.

Misioni

Mision i kësaj strategjie është **kalimi nga transmetimi analog në transmetim digjital** të programeve televizive, sigurimi i cilësisë më të mirë dhe rritja e efikasitetit të transmetimit televiziv dhe përmbajtjeve të tjera me vlerë të madhe për përdoruesit, duke respektuar standardet bashkëkohore në transmetimin digjital.

Objektiva Strategjike 1 - Kompletimi i kornizës ligjore që rregullon kalimin në transmetim digjital tokësor

Korniza ligjore e reformuar do të mundësojë procedurën publike dhe transparente për dhënien e licencave, duke u bazuar në aspektin neutral të përzgjedhjes në bazë të kërkesës nga ofruesit e përmbajtjes, sipas kushteve paraprakisht të përcaktuara dhe jo-diskriminuese, të përshtatura me llojin e shërbimit, lineare ose jo-lineare, që aplikuesi planifikon të ofrojë. Me reformimin e kornizës ligjore, KPM synon të rregullojë procesin e digjitalizimit, kompletimin e kornizës ligjore që rregullon transmetimin digjital tokësorë përmes objektivave të mëposhtme specifike:

Objektivat specifike

- 1.1. Reformimi i kornizës ligjore që rregullon radio-difuzionin në Kosovë, në nivel shtetëror në përputhje me legjislacionin e aplikueshëm, instrumentet e BE-së dhe standardet ndërkombëtare;*
- 1.2. Krijimi i bazës ligjore që rregullon radio- difuzionin në nivel regjional në përputhje me legjislacionin e aplikueshëm, instrumentet e BE-së dhe standardet ndërkombëtare;*
- 1.3. Kompletimi i kornizës ligjore për të siguruar kalimin nga transmetimi tokësor analog në transmetimin tokësor digjital në nivel shtetëror dhe regjional;*
- 1.4. Avansim i bazës ligjore që përcakton rolin, të drejtat dhe detyrimet e të gjithë pjesëmarrësve në prodhimin e përmbajtjeve mediale audio-vizuele dhe zinxhirin e shpërndarjes*

Objektiva strategjike 2 – Rishikimi i planit frekuencor për transmetim televiziv digjital tokësor në nivel shtetëror dhe regjional

Transmetimi televiziv digjital kërkon edhe rishikim të planit frekuencor sidomos në nivel regjional marrë parasysh se duhet të zhvillohen edhe negociata për të alokuar frekuencat adekuate për këtë qëllim. Ky proces do të realizohet duke shfrytëzuar frekuencat ekzistuese të ITU-së në nivel shtetëror dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

KPM synon të përmbushë këtë objektivë strategjike përmes objektivave të mëposhtme strategjike dhe veprimeve të përcaktuara me plan të veprimit të kësaj strategjie.

- 2.1 Modifikimi i mbulueshmërisë me sinjal tokësor digjital në nivel shtetëror duke shfrytëzuar frekuencat ekzistuese të ITU-së;*
- 2.2. Zhvillimi i planit frekuencor për transmetim televiziv digjital tokësor në nivel regjional;*

Objektiva strategjike 3 – Avansimi i standardeve për përmbajtjen programore

Përfitim kryesor i procesit të digjitalizimit është rritja e numrit dhe kualitetit të përmbajtjes programore dhe adresimi i nevojave të qytetarëve. Ky proces do të mundësojë vendosjen e standardeve për ofruesit e shërbimeve mediale dhe operatorëve të multiplexit dhe shumëllojshmëri programore në interes të publikut.

Vendimet për dhënien e licencës duhet të merren për zonat e mbulimit dhe llojin e programeve për të cilat do të jepen licencat e reja. Obligimet e operatorëve të platformës, do të caktohen për të transmetuar përmbajtjen e caktuar (must-carry) dhe obligimet e ofruesve të shërbimeve mediale audiovizuale për të ofruar përmbajtjet e tyre pa diskriminim.

KPM-ja do të garantojë konkurrencë të lirë në tregun publik të shërbimeve mediale audiovizuale. Me qëllim të realizimit të interesit publik në fushën e informimit të rëndësishëm për qytetarët në komunitetet lokale dhe regjionale, kuotat proporcionale minimale të programeve lokale dhe regjionale, duhet të përcaktohen me akt nënligjor për të gjithë të licencuarit nga KPM-ja.

Objektivat e mëposhtme specifike janë zbërthyer me masa përkatëse të veprimit të definuara në plan të veprimit të kësaj strategjie.

4.1. Vendorsja e standardeve për ofruesit e shërbimeve mediale audio vizuale dhe operatorëve të multiplexit në lidhje me ofrimin e përmbajtjes programore;

4.2. Stimulimi i shumëllojshmërisë programore në interes të publikut.

Objektiva strategjike 4 – Qasja në sinjal digjital dhe informimi i publikut

Informimi i qytetarëve, për procesin e kalimit nga transmetimi analog në atë digjital dhe për mundësitë e shërbimeve të reja që ofrohen, është objektivë në vete e kësaj strategjie. KPM synon të organizojë fushata të informimit publik dhe të përgatisë materiale informuese në mënyrë që procesi i digjitalizimit të realizohet me sukses.

Kalimi nga transmetimi analog në atë digjital i programeve televizive është proces shumë i rëndësishëm për interesin publik, të drejtën e qytetarit për të qenë i informuar dhe për të marrë shërbimet e garantuara. Marrë parasysh se ky proces i kalimit ka koston e vet e cila nuk është e përballueshme për të gjithë qytetarët e vendit, KPM synon që të ndihmojë në ndërtimin e një sistemi përfitues për qytetarët të cilët janë pjesë e skemës së ndihmës sociale i cili do të mundësojë subvencionimin me set up box-a dhe do t'u mundësojë atyre qasje në program dhe shërbime kualitative. Realizimi i kësaj objektivë do të bëhet përmes objektivave të mëposhtme specifike:

3.1. Përgatitja e rregullave dhe parimeve për subvencionimin e set up box;

3.2 Mbështetja socio-ekonomike për qytetarët me standard të ulët ekonomik përmes stimulimeve dhe subvencioneve

3.3. Përgatitja dhe realizimi i fushatës së informimit të publikut.

6.1. Alternativat e Konsideruara

Procesi i digjitalizimit është nevojë e kohës në përgjigje të avancimit të teknologjisë dhe mundësive të reja për shërbime drejt maksimizimit të qasjes në informatë dhe kualitetit të përmbajtjes programore të kanaleve televizive.

Digjitalizimi gjithashtu është proces global i rregulluar me parimet bazë të cilat respektohen nga shtetet e ndryshme përfshirë Evropën dhe Ballkanin Perëndimor.

Kosova ka nënshkruar Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit në vitin 2016. Obligimet e marra kanë të bëjnë edhe me respektimin e rregullave dhe parimeve Evropiane radio-difuzive të cilat janë pjesë e kësaj strategjie dhe praktikave më të mira evropiane të shqyrtuara gjatë hartimit të strategjisë.

Specifikat teknike të procesit të digjitalizimit kanë imponuar edhe përmbajtjen e këtij dokumenti strategjik duke u fokusuar në masë të madhe në specifikacionet teknike dhe rregullativen e nevojshme ligjore për funksionim.

6.2. Qasja e Rekomanduar

Nevojat e procesit të digjitalizimit kanë ndikuar në qasjen e rekomanduar e cila është vendosur nga grupet e veçanta punuese të cilat kanë punuar në hartimin e kësaj strategjie. Puna në hartimin e Strategjisë për kalim në transmetimin tokësor digjital në Republikën e Kosovës ka filluar në vitin 2010, përmes grupeve punuese të udhëhequra nga Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) si institucion kompetent për rregullimin dhe menaxhimin e spektrit frekuencor dhe licencimin e shërbimeve mediale audio-vizuele në Republikën e Kosovës. Grupet Punuese janë ndarë në: Grupi Punues për Çështje Ligjore, Grupi Punues për Çështje të Përmbajtjeve Programore, Grupi Punues për Çështje Teknike, Grupi Punues për Çështje Shoqërore-Ekonomike dhe Grupi Punues për Informim dhe Sensibilizim.

Kjo strategji siguron kornizën e nevojshme ligjore, kornizën e nevojshme teknike dhe standarde të avancuara të përmbajtjes programore për transmetuesit radio-difuziv në sistemin e transmetimit digjital në Kosovë. Praktikrat evropiane dhe kriteret e BE-së kanë përcaktuar përmbajtjen dhe kanë udhëhequr punën e reflektuar në këtë strategji.

7. PROCESI I IMPLEMENTIMIT TË TELEVISIONIT TOKËSOR DIGJITAL

Procesi i implementimit të DTT-së paraqet modulën thelbësor në Strategjinë e Digjitalizimit në Kosovë pasi që mundëson aplikimin praktik të parimeve mbi të cilat ndërtohet procesi i digjitalizimit. Njëkohësisht ky modul siguron orientimet bazike të trajtimit të gjendjes aktuale mediale në Kosovë.

Moduli i Implementimit të Strategjisë së Digjitalizimit është hartuar në harmoni me kriteret që mundësojnë që procesi i digjitalizimit në Kosovë duhet t'i nënshtrohet specifikave të veçanta të cilat kryesisht në parim afirmojnë kriteret dhe standardet ndërkombëtare për media dhe në veçanti rekomandimet e KE-së dhe ITU-së. Ky modul afirmon rolin e KPM-së që në procesin e digjitalizimit ka për mision mbrojtjen dhe stimulimin e zhvillimit të tregut medial, sigurimin e parimit të konkurrencës, pluralizmin medial, ruajtjen e identitetit kulturor dhe kombëtar si dhe mundësimin e diversitetit etnik.

Përmbushja e këtyre synimeve, të cilat do t'i mundësojë moduli i implementimit të digjitalizimit tokësor televiziv, është dakorduar në komunikimet e deritanishme që KPM-ja ka zhvilluar me industrinë mediale në Kosovë, institucionet relevante kosovare, bazuar në analizat dhe krahasimet e praktikave evropiane për vendet që veç kanë përfunduar digjitalizimin, si dhe duke përfunduar me konsultimet dhe asistimet e ekspertëve ndërkombëtar nga Komisioni Evropian.

Moduli i Implementimit parasheh aktorët të cilët marrin pjesë në procesin e digjitalizimit, rolin e tyre në faza të ndryshme, afatet kohore, përcaktimin e kriterëve për konkurrim dhe të gjitha veprimet që duhet të mirren në fazën e aplikimit dhe realizimit.

Procesi të implementimit i paraprin faza e plotësimit dhe përshtatjes së legjislacionit adekuat si dhe respektimin e plotë të procedurave që parashohin ligjet në Kosovë, duke respektuar interesin primar të publikut, parimin e konkurrencës dhe transparencën e plotë të tërë procesit nga fillimi deri në përfundim. Procesi i Implementimit të DTT përfshin nivelin nacional dhe regional/lokal si dy aktivitete të ndara, por të cilat do të zhvillohen paralelisht me qëllimi të sigurimit të vazhdimësisë së transmetimit në të dy nivelet.

Trajtimi ndaras i transmetimit tokësor digjital tokësor në nivel nacional dhe regional/lokal bëhet edhe për arsye se përfshirja e operatorëve regional/lokal nuk mund të bëhet në multipleksat (MUX) nacional për shkak të numrit të kufizuar të frekuencave/MUXave që kushtëzojnë aplikimin e rrjetës transmetuese SFN (Single Frequency NetWork.)

DTT në Kosovë në nivelin nacional dhe regional do të bëhet në dy faza.

Faza e parë është periudha e kalimit në digjitalizim të transmetimeve tokësore sipas përcaktimit të dhënë në Ligjin Nr. 05/L-027. Ligji për Digjitalizim nuk është bazuar në Strategjinë për kalim në transmetim digjital të përgatitur nga KPM-ja . Ligji parasheh vetëm digjitalizimin në nivel shtetëror ndërsa Strategjia e KPM-së shërben për digjital izim të transmetimit edhe në nivel regional dhe për vazhdim të digjital izimit në nivel shtetëror edhe pas fazës së parë që do të realizohet sipas Ligjit për Digjitalizim.

Faza e dytë është pas periudhës së shkyçjes së transmetimit analog tokësor televiziv (ASO).

7.1. Faza e parë – periudha tranzitore

Implementimi i DTT-së në nivel shtetëror

Frekuencat (që në digjitalizim zëvendësohen me Multipleksa ose MUX-a) janë resurse kombëtare dhe do të jipen në koncesion me një tender publik. Procesi i tenderimit është përcaktuar në Shtojcën e Ligjit Nr.05/L-027.

Multipleksët në kanal 46 dhe kanal 58

Ligji për Digjitalizimin e Transmetimeve radiodifuzive i miratur nga Kuvendi ka përcaktuar që kalimi në transmetim digjital do të bëhet me lejimin e dy kanaleve, kanalit 46 dhe kanalit 58, të cilët do të jipen me tender publik.

Fituesi i kësaj gare (fituesi i të drejtës për shfrytëzim me koncesion të kanalit 46 dhe kanalit 58) përveç kushteve tjera duhet t'i plotësojë edhe kërkesat e veçanta dhe të përgjithshme të cilat do t'i përcaktojë KPM-ja në dokumentet tenderuese.

Gjatë periudhës tranzitore në këto kanale do të aplikohet parimi “must carry” (bartje e detyrueshme) për televizionet me mbulueshmëri nacionale tokësore të cilat veç janë të licencuara nga KPM-ja për transmetim tokësor analog (kanalet e transmetuesit publik RTK pa afat kurse për

kanalet e televizioneve komerciale nacionale RTV21 dhe KTV është përcaktuar që të kenë statusin e bartjes së detyrueshme deri në afatin e skadimit të licencës për transmetim analog).

Parimi “must carry” do të aplikohet për këto arsye:

- Që publiku të vazhdojë të jetë i informuar nga mediat që i ka përdorur si mjetet kryesore për të pranuar programin televiziv që i dedikohet atij;
- Që t’i garantohet publikut të kenë qasje në gjuhën e tyre në lajme nacionale/kombëtare, informim, edukim, dhe debate kulturore dhe shoqërore;
- Që të ruhet dhe promovohet pluralizmi medial dhe diversiteti kulturor;
- Që të përkrahet dhe të ofrohet përmbajtja lokale / vendore në mesin e përmbajtjeve të reja që do të ofrohen;

Multipleksi i Transmetuesit Publik

Transmetuesit publik (RTK) do t’i ndahet një MUX me automatizëm, pa garë publike.

MUX i transmetuesit publik do të shfrytëzohet për kanalet e veta dhe eventualisht për kanalet tjera jokomerciale nën kushtet e miratuara nga KPM. Kanalet me përmbajtje të përgjithshme, jo tematike, të transmetuesit publik në MUX 3 që janë në interes të publikut do të ofrohen pa pagesë (Free to Air). KPM do të përcaktojë kriteret për zgjedhjen e këtyre kanaleve.

Televizioni publik është i obliguar që të sigurojë transmetim me mbulueshmëri në nivel shtetëror në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

Implementimi i DTT-së në nivel regjional

Kalimi në transmetimin digjital në nivelet regjionale të Republikës së Kosovës, do të realizohet në kuadër të pesë suballotmenteve:

- Sub allotmenti i Rrafshit të Kosovës;
- Sub allotmenti i Rrafshit të Dukagjinit;
- Sub allotmenti i Mitrovicës;
- Sub allotmenti i Anamoravës;
- Suballotmenti i Prishtinës;

KPM do të përcaktojë çmimin fillestar për koncesionimet e veçanta të suballotmenteve bazuar në kriteret të caktuara.

MUX-at e suballotmentëve Rrafshi i Kosovës, Dukagjinit, Mitrovicës dhe Anamoravës

KPM do të shpallë garë publike për përzgjedhjen e operatorit të MUX-it për sub-allotmentin respektiv të Rrafshit të Kosovës, Dukagjinit, Mitrovicës dhe Anamoravës.

MUX-i i suballotmentit të caktuar do të menaxhohet nga konsorciumet/asociacionet e përbëra nga entitetet ligjore, shërbimet mediale audiovizuale të licencuara nga KPM për transmetim tokësor.

Fituesi i koncesionimit (operatori i MUX-it të sub allotmentit të caktuar), do të bart kanalet historike regjionale/lokale me transmetim tokësor të licencuara nga KPM-ja me parimin “must-carry” sipas kritereve të përcaktuara nga KPM;

Operatori, fituesi i MUX-it të sub allotmentit të caktuar obligohet të sigurojë transmetim me mbulueshmëri 95% të popullatës së regjionit të caktuar dhe këtë do ta realizojë brenda afatit të caktuar nga KPM-ja; Në rast të mos shprehjes së interesit, apo mospërmblidhjes së kritereve të koncesioneve/asociacioneve, atëherë MUX-at regjional do t’i jipen në menaxhim operatorit juridik me një garë publike komerciale.

MUX i suballotmentit Prishtina

KPM do të shpallë garë publike për përzgjedhjen e operatorit të MUX-it për sub allotmentin Prishtina;

Megjithatë në suballotment Prishtina nuk kemi entitete audio-vizuale të licencuara për transmetim tokësor nga KPM-ja, atëherë koncesionimi-menaxhimi i MUX-it të suballotmentit Prishtina do të bëhet nga një ose disa operator që ofrojnë shërbime audio-vizuale të cilat i plotësojnë këto kritere:

- Kanë përvojë në prodhim të programit-përmbajtjes;
- Ofrojnë program të përgjithshëm duke plotësuar nevojat e publikut të regjionit të Prishtinës
- Kanë krijuar audiencën e vet.

Fituesi i koncesionimit (operatori i MUX-it të sub allotmentit Prishtina), do të bart me parimin “must-carry” kanalet që ofrojnë program gjeneralistik me interes të publikut të regjionit të Prishtinës. Kjo do të përcaktohet me kritere të qarta nga KPM-ja.

Operatori, fituesi i MUX-it të sub allotmentit Prishtina obligohet të sigurojë transmetim me mbulueshmëri 95% të popullatës së regjionit të caktuar dhe këtë do ta realizojë brenda afatit të caktuar nga KPM-ja.

7.2 Faza e dytë - çkyçja e transmetimit analog (“switch off”)

Faza e dytë do të fillojë menjëherë pas shkyçjes së sinjalit analog të transmetimit.

Multipleksët shtetëror me "Beauty Contest" MUX4 dhe MUX5

Koncesionimi i dy MUX-ave tjerë (MUX4 dhe MUX5) do të bëhet menjëherë pas fazës së parë, poashtu me një garë publike të tipit “Beauty Contest”.

KPM do të bëjë ftesën për shprehje interesi në bazë të kritereve si në vijim:

- Përvoja në menaxhim dhe transmetim radiodifuziv tokësor televiziv në Republikën e Kosovës;
- Lloji i programit i dedikuar për publikun;
- Përmbajtje programore gjithëpërfshirëse të interesit qytetar të mbarë Kosovës;
- kontributi në identitetin qytetar dhe kombëtar;
- Sigurimi i rrjetës me mbulueshmëri nacionale si infrastrukturë transmetuese digjitale tokësore SFN sipas standardeve të ITU për parametrat e rrjetit të referencës RN1;

Pas analizimit dhe vlerësimit të fazës së parë të kalimit në transmetim digjital, KPM do të hartojë kriteret shtesë varësisht nga nevojat që duhet të përmbushen në interes të publikut.

Lejimi i MUX4 dhe MUX5 bëhet veç e veç për dy entitete të ndara. Mbi bazën e çmimeve fillestare të koncesionimit të MUX-eve komercial (fazën e parë), por duke zvogëluar pagesën për një kanal transmetues në HD (High Definition), do të caktohet edhe çmimi për MUX-at e fazës së dytë (MUX4 dhe MUX5).

Në rast të mos shprehjes së interesit, apo mospërmbushjes së kriterëve për “Beauty Contest”, atëherë MUX4 dhe MUX5 do të licencohen me një garë publike komerciale.

MUX-at e mbetur (MUX6 dhe MUX7) si dhe MUX-at tjerë që mund të jenë në disponim të Republikës së Kosovës në të ardhmen do të trajtohen nga KPM-ja konform nevojave të tregut medial në Kosovë.

Të gjitha çështjet tjera që mund të ngriten si rezultat i paqartësive për implementim të DTT-së do të rregullohen me akte nënligjore-rregullore përkatëse nga ana e KPM-së.

8. KORNIZA EKONOMIKO-SHOQËRORE

Kostoja financiare e kalimit në transmetim digjital

Realizimi i strategjisë nacionale për transmetimin digjital kërkon një kosto të veçantë financiare. Shteti duhet të sigurojë që popullata të ketë qasje në programet televizive për familjet të cilat nuk mund të bartin shpenzimet që kërkohen. Duhet të planifikohet subvencionimi për familjet e kategorisë me asistencë sociale. Sipas Agjencionit të Statistikave të Kosovës, në tre muajt e tretë të vitit 2014 është vlerësuar të jenë 29,538 familje që përfitojnë nga skema sociale dhe 13,062 familje të dëshmorëve dhe invalidëve të luftës. Për subvencionim të kësaj kategorie, respektivisht për sigurimin e Set-top-Box (STB) për to, kostoja që duhet të investohet arrin shumë prej 852,000.00 Eurosh (duke llogaritur vlerën e një STB, MPEG4 DVB-T2, prej 20 Euro). Mirëpo, krahas kësaj kategorie, janë edhe disa përfitues tjerë të cilët duhet të subvencionohen. Kostoja e përgjithshme për të gjitha kategoritë dhe personat është llogaritur në vlerën prej 4,483,440.00 euro.

Ndihmesë të madhe në sigurimin e fondeve për digjitalizim për vendet anëtare të BE-së dhe ato që pretendojnë t'i bashkohen BE-së, ka dhënë edhe Komisioni Evropian. Të ardhura të konsiderueshme mund të realizohen edhe nga investitorët privat apo koncensionarët.

Ndikimi financiar për transmetuesit

Në mënyrë që të përcaktohet se çfarë do të jetë kostoja e drejtë e qasjes në rrjete, hapi i parë duhet të jetë një vlerësim i saktë i koston së çdo elementi përbërës të rrjetit digjital. Elementet³ e një rrjeti digjital të propozuara në strategji janë:

- Rrjeti kontributiv;
- Multipleksi - Head-End;
- Rrjeti distributiv dhe radio-difuziv;
- Ndërtimi i infrastrukturës për rrjetin radiodifuziv.

Kostoja e ndërtimit të rrjetit SFN në Kosovë duke shfrytëzuar katër pika transmetimi të definuara në strategji është 1.9 milion Euro, ndërsa, ndërtimi i infrastrukturës së rrjetit vlerësohet të jetë afro 16 milionë Euro⁴.

Transmetuesi Publik i Kosovës (Radio Televizioni i Kosovës)

Transmetuesit publikë në vendet e BE-së, kanë luajtur një rol të rëndësishëm gjatë kalimit në transmetimin digjital. Shumë shtete kanë mbështetur në forma të ndryshme financiare transmetuesit publik, që me sukses të kalojnë nga transmetimi analog në digjital. Krahas koston për subvencionim, duhet konsideruar edhe koston për digjitalizim⁵ të transmetuesit publik me qëllim që qytetarëve të Kosovës t'u mundësohet të kenë qasje në programe me interes të publikut. RTK-së i është caktuar që të ketë një Multipleks në të cilin do të akomodohen vetëm programet të cilat i prodhon vet. Kuvendi i Republikës së Kosovës, si themelues i Radio Televizionit të Kosovës, duhet të sigurojë mbështetjen e nevojshme financiare për RTK-në, i cili e ka detyrim ligjor mbulimin e gjithë territorit të Kosovës.

Stacionet televizive komerciale

Të gjitha stacionet televizive do të ballafaqohen me kosto shtesë gjatë procesit të digjitalizimit, veçanërisht gjatë periudhës së transmetimit të njëkohshëm kur të dy rrjetet analoge dhe digjitale janë në veprim. Megjithatë, financimi i rrjeteve analoge gjatë periudhës së transmetimit të njëkohshëm, për ato kanale televizive që transmetojnë edhe në rrjetin digjital, është opsion i zbatueshëm. Barra e koston së dyfishtë të rrjetit, duhet të ndahet në mes transmetuesve, ndërsa funksionimi afatgjatë i dyfishtë (analog dhe digjital), në fakt nuk është në interes të transmetuesve. Për të zvogëluar shpenzimet e periudhës së tranzicionit preferohet një periudhë e shpejtë e tranzicionit.

Ndikimi financiar për shikuesit

Mbrojtja e konsumatorit është një aspekt i rëndësishëm që duhet të mirret në konsideratë gjatë kalimit në transmetimin digjital. Konsumatorët duhet të mbrohen nga shpenzimet për aparatin televiziv joadekuat, përderisa në kohën e njëjtë duhet të ruhet konkurrenca e tregut. Prandaj,

³ Përkufizimi i tyre është i dhënë në pjesën teknike

⁴ Vlerësimi është bërë duke u bazuar në analizat e KPM-së me referencë për territorin e Kosovës, dhe me analizë krahasimore duke u bazuar në përvojat e shteteve të rajonit.

⁵ Sipas vlerësimeve të RTK-së, RTK ka vlerësuar që për digjitalizimin e tyre nevojiten 20 milion Euro për rrjetin dhe 5 milion për prodhim të programit dhe digjitalizim të brendshëm.

është shumë e rëndësishme që të përcaktohen specifikimet teknike dhe standardet e pajisjeve të nevojshme për një familje.

Zgjedhja teknike e ofruar në strategji, implikon një kosto të blerjes së pajisjeve pranuese të sinjalit digjital (Set-top-box), që rekomandohet të subvencionohet nga Qeveria për kategori të caktuara.

Fushata promovuese për procesin e digjitalizimit duhet t'i kontribuojë mbrojtjes së konsumatorit. Gjatë fushatës, konsumatori duhet të informohet për procesin dhe modalitetet e kalimit dhe të çdo subvencionit.

Subvencionimi

Lidhur me rolin e shtetit dhe format e pranueshme të mbështetjes publike ka praktika të mira të ndryshme evropiane. Praktikën më të mira dhe përvojat evropiane tregojnë se opsioni më i mirë është subvencionimi për blerjen e pranuesve (Set-top-box). Skemat e subvencionimit duhet të inkurajojnë të gjitha familjet për të blerë një marrës DVB-T2, për të minimizuar periudhën e tranzicionit dhe kështu të reduktojnë koston e përgjithshme të procesit të kalimit nga sistemi analog në digjital.

Përvojat në regjion tregojnë se subvencionet janë përdorur në mënyrat e mëposhtme:

- Provizion në DVB-T2 pranues (receiver) apo
- Subvencionimi i një pjese të çmimit të pranuesit DVB-T2 (receiver), në formë të kuponave.

Qeveria e Kosovës, me Ligjin për Digjitalizimin e Transmetimeve Radiodifuzive Tokësore, ka përcaktuar masat stimuluese për konsumatorë. Më konkretisht, në Nenin 12 të këtij ligji është përcaktuar që:

- të mbështesë, me fondet në dispozicion, realizimin e transmetimeve radiodifuzive digjitale, përmes masave stimuluese për konsumatorë, apo bashkëfinancimit të blerjes së marrësve të sinjalit televiziv digjital për konsumatorët në gjendje shoqërore më të pafavorshme;
- marrësit e bashkëfinancuar nga Qeveria do të jenë neutralë në aspektin teknologjik dhe do të shfrytëzojnë standarde të hapura të ndërveprimit
- përfitues të masave të tilla stimuluese janë kategoritë e rasteve sociale, të cilat janë të përcaktuara nga Ministria përkatëse për çështje sociale.
- Ministria përkatëse për çështje sociale do të bëjë ftesë publike për personat që kanë të drejtë të aplikojnë për bashkëfinancim për marrjen e vauçerit për marrës televiziv digjital dhe do të përcaktojë përfituesit që do të bashkëfinancohen.

Sipas të dhënave nga Agjensioni i Statistikave të Kosovës të vitit 2016:

- 26,302 familje kosovare janë të përfshira aktualisht në skemën sociale me (gjithesë 107,575 antarë) . Numri i familjeve ka ndryshuar nga viti në vit për shkak të miratimit të ligjeve të reja, forcimit të kontrollit të brendshëm të MPMS, miratimit të kritereve të reja dhe zbatimit të akteve të reja ligjore. Ndihma sociale është në proces të reduktimit në dy vitet e fundit.
- Në Kosovë ka 120,017 pensionistë bazë dhe 41,315 pensionit kontributpagues. AST-ja nuk ka informacion për pensionistët që jetojnë vetëm, pa përkrahjen e anëtarëve të tjerë të familjes. MPMS-ja sugjeron që kjo kategori të përfshihet në skemën e subvencionit.

- 12,680 familje të dëshmorëve dhe invalidëve të luftës janë duke marrë ndihmë nga skema. Këto familje janë të ndara në 10 kategori. MPMS-ja sugjeron që të gjitha këto familje të përfshihen në skemën e subvencionit për digjitalizimin.
- Në Kosovë janë 19,833 pensionist me aftësi të kufizuara (18-65 vjeç) . MPMS-ja sugjeron që të gjitha këto familje, të përfshihen në skemën e subvencionit për digjitalizimin;
- Në Kosovë janë 2,737 Fëmijë që përfitojnë nga skema e fëmijëve me aftësi të kufizuar (0-18 vjeç), persona të moshuar pa përkujdesje familjare 107, persona të vendosur në Institutin e Shtimes 131 dhe fëmijë të braktisur 42.
- Numri i përgjithshëm i familjeve që kanë nevojë për subvencione është 45,776 duke përjashtuar tri kategoritë e pensionistëve. Vlera e subvencionit do të parashihet në Planin e veprimit të kësaj strategjie, pasi çmimi i pranuesit DVB-T2 është në rënie çdo vit. Çmimi i pranuesit DVB-T2, në momentin e shkrimit të kësaj strategjie është rreth 20 euro (DVB-T2/MPEG-4).

Kategoritë	Numri i familjeve	Shuma 20 € për STB
Familjet që përfitojnë nga skema sociale, familjet e dëshmorëve dhe ivalidëve të luftës	38,982	779,640.00€
Fëmijët me aftësi të kufizuar (0-18 vjeç), persona e moshuar pa përkujdesje familjare, persona të vendosur në institutin e Shtimes dhe fëmijë të braktisur	3,017	60,340.00 €
Pensionet e personave me aftësi të kufizuara (18-65 vjeç	19,833	396,660.00 €
Pensionist kontribut pagues	41,315	826,300€
Pensione bazë	120,017	2,400.340.00 €
Totali	223,164.00 familje	4,463.280.00 €

Tabela 9. Subvencionimi i llogaritur për kategori të caktuara (sipas ndarjes së MPMS) digjital digjital

9. INFORMIMI PUBLIK

Për procesin e digjitalizimit është e nevojshme një fushatë e informimit publik të qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Qytetarët duhet të jenë të informuar për ndryshimet në pranimin e sinjalit digjital , afatet kohore si dhe mënyrën e furnizimit me pajisje-marrës (resiverët). KPM në vazhdimësi do të informojë publikun për aktivitetet gjatë procesit të digjitalizimit.

Për të implementuar Strategjinë, KPM-ja ka hartuar dinamikën e realizimit, etapat dhe drejtimet e zhvillimit të planit të vet strategjik, për të siguruar kalim efikas nga transmetimi analog në atë digjital.

KPM-ja do të bashkërendojë aktivitetin e saj me Qeverinë e Republikës së Kosovës, ministrinë përkatëse, institucionet tjera dhe shoqërinë civile. Për fushatën e informimit publik, krahas angazhimit të ekspertëve, KPM do të kontribuojë në realizimin e detyrave dhe aktiviteteve sipas planit të veprimit.

SHTOJCA 1 - Korniza Ligjore

Korniza rregullative e ligjeve të zbatueshme në Republikën e Kosovës në fushën e rregullimit dhe funksionimit të shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale përbëhet nga:

- Ligji Nr. 05/L-027 për Dixhitalizimin e Transmetimeve Radiodifuzive Tokësore, miratuar me 30 korrik 2015;
- Ligji Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave, miratuar me 5 prill 2012;
- Ligji Nr. 05/L -047 Për Ndryshimin Dhe Plotësimin E Ligjit Nr.04/L-065 Për Të Drejtat E Autorit Dhe Të Drejtat E Përafërta
- Ligji Nr. 03/L-73 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, miratuar më 15 qershor 2008;
- Ligji Nr. 02/L-65 Ligji Civil kundër Shpifjes dhe Fyerjes, miratuar më 1 maj 2008;
- Ligji Nr. 04/L-121për Mbrojtjen e Konsumatorit, miratuar më 20 nëntor 2012;
- Ligji Nr. 03/L-229për mbrojtjen e Konkurrencën, miratuar më 25 nëntor 2010;
- Ligji Nr. 04/L-109 për Komunikimet Elektronike, miratuar më 9 nëntor 2012;

Transmetuesi Publik i Kosovës (RTK) rregullohet me ligj të veçantë, Ligjin Nr. 04/L-046 për Radio Televizionin e Kosovës.

KPM, duke u bazuar në obligimin ligjore të dhenë nga Ligji për Digjitalizim Nr. 05/L-027, në vitin 2017 ka hartuar dhe miratuar këto Rregullore;

- Rregullorja KPM-2017/01, për operatorët e multipleksit në nivel shtetëror;
- Rregullorja KPM-2017/02, për ofruesit e shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale;
- Rregullorja KPM-2017/03, për tarifën vjetore për licencë;
- Rregullorja KPM-2017/04, për bartjen e detyrueshme të ofruesve të shërbimeve mediale audiovizuale në operatorin e multipleksit;
- Rregullorja KPM-2017/05, për renditjen logjike të kanaleve.

Me miratimin e këtyre rregulloreve KPM ka përmbushur obligimin e dhenë ligjor dhe ka ndërtuar një infrastrukturë ligjore e cila do të mundësojë fillimin e implementimit të transmetimit digjital në Kosovë.

Pas hyrjes në fuqi të Ligjit të ri për KPM-në Nr. 04/L-44, në kuadër të obligimit ligjor të harmonizimit të të gjitha akteve nënligjore me ligjin e ri, KPM ka miratuar në vitin 2013 këto akte:

- Rregullorja KPM-2013/01, për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audio-Vizuele;
- Rregullorja KPM-2013/02, për të Drejtën e Autorit;
- Rregullorja KPM-2013/03, për Komunikime Komerciale Audio-Vizuele;
- Rregullorja KPM-2013/04, për Dhënien e Licencës;
- Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës së KPM-së.

Gjatë vitit 2014 KPM ka miratuar këto rregullore:

- Rregullorja KPM-2014/02, për vlerësimin e aplikacioneve për licencë të KPM-së;

Ndërsa, e ka amandamentuar:

- Rregullore KPM-2014/03, për nivelin dhe mënyrën e pagesës së tarifës për licencë.

Gjatë vitit 2016 KPM ka miratuar rregulloren:

- Rregulloren KPM-2016/01, për shpërndarjen e ofruesve të shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale;

Ndërsa, i ka amandamentuar:

- Rregulloren KPM-2016/02, për komunikimet komerciale audiovizuale;
- KKPM-2016/03, Kodi i etikës për ofruesit e shërbimeve mediale në Republikën e Kosovës.

KPM gjithashtu Aktet e Këshillit të Evropës (KE) kryesisht i ka inkorporuar në legjislacionin në fuqi të Republikës së Kosovës. Aktet e referuara të KE-së, veçmas përfshijnë aktet e mëposhtme:

- Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
- Karta Evropiane për Gjuhët Rajonale apo Pakicave;
- Rezoluta për të Drejtën e Përgjigjes;
- Deklarata për Lirinë e Shprehjes dhe Informacionit;
- Rekomandimi mbi Pluralizmin e Mediave dhe Diversitetin e Përmbajtjes së Medias
- Deklarata mbi Rolin e Komunitetit të Mediave në Promovimin e Kohezionit Social dhe Dialogut Ndërkulturor;
- Deklarata për Lirinë e Debatit Politik në Media;
- Rekomandimi për të Drejtën e Përgjigjes në Mjedisin e ri Mediatik.

KPM-ja ka harmonizuar rregulloret me Direktivën e AVMS-së, si dhe me aktet juridike të BE-së, që përfshijnë aktet në vijim:

- Direktiva e Shërbimeve Mediale Audio-Vizuele;
- Protokolli mbi Sistemin e Transmetimit Publik në Shtetet Anëtare;
- Komunikimi nga Komisioni mbi Zbatimin e Rregullave të Ndhmës Shtetërore ndaj Shërbimit Publik të Transmetimit;
- Vendimi për Programin e Mediave;
- Rekomandimi për Mbrojtjen e të Miturve;
- Konkluzioni mbi Parimet e Politikës Audio-vizuele të Komunitetit;
- Vendimi për Përmbajtje Ndër-Aktive në Media;
- Rekomandimet për Mbrojtjen e të Miturve dhe Dinjitetit Njerëzor;
- Rekomandimi për Zhvillimin e Konkurrencës;
- Rezoluta për të Intensifikuar Shkëmbimin e Informacionit; dhe
- Konkluzioni për Zbatimin e Rekomandimeve për Mbrojtjen e të Miturve.

Korniza ligjore ekzistuese në Kosovë që ka të bëjë me autoritetin dhe rolin e KPM-së, në mënyrë të vazhdueshme duhet të plotësohet me qëllim që të rritet efikasiteti i skemës së licencimit, të prezantohen role të reja për subjektet e reja të sektorit të televizionit digjital dhe të hapet rruga për rregullimin e shërbimeve konvergjente.

SHTOJCA 2- Të dhënat sipas mbulueshmërisë gjeografike dhe të popullatës:

1. *RTK 1* (transmetuesi i shërbimit publik, kategoria nacionale) mbulon 30 komuna⁶ me 1,503,916 banorë;
2. *KTV* (kategoria nacionale) mbulon 29 komuna me 1, 503,196 banorë;
3. *TV 21* (kategoria nacionale) mbulon 29 komuna me 1,503,196 banorë;
4. *TV Ballkan* (kategori regjionale) mbulon 4 komuna me 292.867 banorë;
5. *TV Besa* (kategori regjionale) mbulon 7 komuna me 426.009 banorë;
6. *TV Herc* (kategori regjionale) mbulon 10 komuna me 375.916 banorë;
7. *TV Mir* (kategori regjionale) mbulon 5 komuna me 82.607 banorë;
8. *TV Mitrovica* (kategori regjionale) mbulon 8 komuna me 554.696 banorë;
9. *TV Opinion* (kategori regjionale) mbulon 7komuna me 426.009 banorë;
10. *TV Prizren* (kategori regjionale) mbulon 7 komuna me 426.009 banorë;
11. *TV Puls* (kategori regjionale) mbulon 5 komuna me 136.974 banorë;
12. *TV Syri Vision* (kategori regjionale) mbulon 7 komuna me 360.797 banorë;
13. *TV Vali* (kategori regjionale) mbulon 5 komuna me 136.974 banorë.
14. *TV Dukagjini* (kategori lokale) mbulon 3 komuna me 172.602 banorë;
15. *TV Festina* (kategori regjionale) mbulon 2 komuna me 135.978 banorë;
16. *TV Iliria* (kategori lokale) mbulon 2 komunë me 46.959 banorë;
17. *TV Liria* (kategori lokale) mbulon 2 komuna me 135.978 banorë;
18. *TV Most* (kategori lokale) mbulon 4 komuna me 141.482 banorë;
19. *TV Tema* (kategori regjionale) mbulon 6 komuna me 296.677 banorë;
20. *TV Zoom* (kategori regjionale) mbulon 4 komunë me 90.015 banorë;

⁶ Prishtinë, Fushë Kosovë, Obiliq, Vushtri, Lipjan, Shtimje, Ferizaj, Pejë, Gjakovë, Prizren, Klinë, Gjilan, Ranilluk, Partesh, Klllokot, Kamenicë, Viti, Mitrovicë, Mitrovice e Veriut, Rahovec, Podujevë, Istog, Mamush, Junik, Gracanica, Novobërdë, Deçan, Malishevë, Suharekë dhe Zveçan. RTK mbulon një komunë më shumë sesa dy kanalet tjera komerciale nacionale (Komunën e Novobërdë)

SHTOJCA 3 - Lista e operatorëve të shpërndarjes

Në Kosovë ekzistojnë 40 operatorë të licencuar nga KPM: Ipko Telecommunications dhe Kujtesa Net, që janë 2 operatorë të shpërndarjes me shtrirje më të gjerë në territorin e Republikës së Kosovës dhe 38 operatorë të tjerë janë me shtrirje lokale: Eagle (Prizren), Elektra (Hani i Elezit), TV EHO (Reçan), Progres (Shtërpce), NET TV (Lubinjë - Prizren), Link Produkcija (Graçanicë), Dream (Dragash) dhe Kumanova Cable (Suharekë), Intersat (Drenas), KDS Telestar IC (Ropotovë/Kamenicë), NSH Drinia Net (Ratkoc), EGC (Vllashne/Prizren), BB Herc (Shtërpce), Connect 3 (Prizren), Connect ISP (Dragash), Orange NET (Gjilan - Kamenicë), Vision TV (Podujevë), Astra – T (Shtërpce), Art Motion (Prishtinë), IPTV Tech LLC (Ferizaj), High Speed (Podujevë), Bledi (Malishevë), ISP Broadcast (Malishevë), Vala Net (Therandë), Galaktika (Prizren), TV (Skënderaj), Max, NTP ARDI (Podujevë), J&B Net (Pejë), KliNet (Klinë), Internet Albi & Net (Malishevë), Kadria Net (Istog), IPTV Fiber Link (Gjakovë); IPTV Telekom i Kosovës (tërë Kosovën), IPTV Tel Communications LLC (Prizren), Dot Net (Shtime), OTT Vista (Suharekë), IPTV Tel Kos LLC (Prishtinë) dhe TVN Cable TV (Prishtinë) .

SHTOJCA 4 - Lista e ofruesve të shërbimeve mediale audiovizuale përmes operatorëve të shpërndarjes

KPM ka licencuar 61 ofrues të shërbimeve mediale audiovizuale (OSHMA) që shpërndajnë programet e tyre përmes operatorëve kabllorët shpërndarjes: Rrokum TV, Klan-Kosova, RTK 2, RTK-3 Neës, RTK-4 art, TV Arta, 1st Channel, 21 Junior, 21 Plus, 21 Popullore, 21 Mix, A9 International TV, A-Mol TV, ART, Business Channel, Click Channel, Dasma TV, ETV, K-MusicKosova MTV, K-sport 1, K-sport 2, K-sport 3, K-sport 4, K-sport 5, KutiaTV, MBTV, Neës TV, Next television, Olti TV, On TV Channel, Plus TV, Star TV, Tribuna Channel, Turbo Channel, TV Dialog, TV Diaspora, TV Globi, TV Kim, TV Kosova Channel, TVR, Zico TV, TV Gracanica, TV Nonstop Shop, Tele bet, TV Tajna, Balkan Hot2, Balkan Hot, Travelingo TV, Suite TV, Labia TV, TV 7, TV Llapi, Positive Gold TV, Spin TV, UBT TV, TV Premium, TV Dielli, Zeri TV, Tele 1, TV Kiss, .

SHTOJCA 5 - Situata e kanaleve 7, 31, 44, 46, 48, 58 dhe 67 në planin GE-06 për Kosovën

